REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 915-923/20
Datë/Datum. 23.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Blerina Huruglica ***Ekspert Shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***10.11.2020***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***23.11.2020***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **10.11.2020, OE "TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK" dhe më datën 13.11.2020, OE"INFRATEK"SHPK,** kanë parashtruar ankesë me nr: **915-923/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE "Arhiko Ing OP",** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Hartimi I Projekteve"** me nr. të prokurimit: **VU644-20-713-2-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E VUSHTRRISË**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **300.000,00€.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:
Data e njoftimit për kontratë:06.03.2020
Data e hapjes së ofertës:06.04.2020
Data e njoftimit për dhënien e kontratës Rivlerësim: 26.10.2020
Data e njoftimittë ofertuesve të pasuksesshëm Rivlerësim:26.10.2020

Ankesa është e përsëritur Vendimi i OSHP-së Nr.395-404/20 të dt. 28.07.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Sa i përket pretendimeve të OE ankuesit "TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK":

PRETENDIMI ANKIMORË 1:

Eleminimi jonë lidhur me pretendimin që njëri prej Grupit Operatorëve në këtë rast Taulant Shpk, ka dorëzuar Deklarate nen Betim jo valide, konsiderojmë pretendim ankimorë të gjykuar "Rest Juridicata", nuk është dashur ta përdorë AK pretendim për eleminimin tonë.

Gjatë plotësimit të deklaratës në Betim, ka ndodhur një devijim i vogël teknik për arsyes se kjo deklaratë në betim tek pjesa e identifikimit të OE është plotësuar qartë, këtu kemi parasysh faktin se emri i OE-së i mbetur si gabim teknik rezulton të jetë emri i antarit të OE-ve që janë antarë të grupit të OE-ve që janë në konzorcium njeri me tjetrin dhe kjo shihet qartë se është një gabim teknik që nuk ndryshon kushtin material të aktivitetit të prokurimit nga se gabimet të cilat mund të korigjohen pa ndryshuar kushtin material bazohen në NENI 59.4 të LPP-së.

Neni 59
Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve

Ky pretentim ankimorë e konsiderojmë të gjykuar " Rest Juridicata",Konform mendimittë ekspertit, dhe vendimit OSHP-së NR 395-404/20 të dates 28.07.2020.

PROVË MATERIALE :

O.E. " Studio Hapësira "Sh.p.k., ndërsa të dhënat më tej për O.E. " Taulant "Sh.p.k. Kjo e bënë Deklaratën nën Betim fictive, jo të rregullt dhe jo valide, për rrjedhojë dhe të papranueshme për A.K. Në fakt kjo parregullsi paraqet devijim substancial nga Kërkesat Administrative të saktësuara në Dosjen e Tenderit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se gabimin në deklaratën nën betim mund te konsiderohet një devijim i vogël teknik për arsye se kjo deklaratë tek pjesa Identifikimi i OE-së është e plotësuar qartë, këtu kemi parasysh faktin se emri i OE -së i mbetur si gabim teknik rezulton te jete emri i anëtarit te grupit te OE-ve qe janë në konzurcium njeri me tjetrin dhe kjo shihet se është veç një gabim teknik që nuk ndryshuar kushtin material te aktivitetit të prokurimit nga se gabimet të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material parashihen edhe në nenin 59.4 të LPP-së.

Bazur në proven materiale në **Pretendimin NR 1**; Autoriteti Kontraktues Komuna Vushtrri I ka

ikur Vendimittë Oshp-së **OSHP-së NR 395-404/20 të dates 28.07.2020 dhe mendimi ekspertit, me këtë rast veprimi i Autoritetit Kontraktues është i palejuar dhe kundërshtim me NENI59 paragrafi 4.**

PRETENDIMI ANKIMORË 2:

- **Një (1) inixhinier i diplomuar i ndërtimtaris (drejtimi konstruktiv) – minimum 3 vite përvoj pune pas diplomimit dhe të kete te kryer së paku dy (2) projekte të përfunduara të mureve ose urave BA;**
  - Nuk është paraqitur në CV pune të projekteve të mureve ose urave BA për Eldo Liko. *Bazuar në nenin 39.8 të ROUP (citat) atëhere kur O.E ofron CV që nuk i përmbush kriteret atëhere duehet të refuzhet pa kerkim të infomacioneve shtese duke u mbestetur nënenin 69 të LPP-së (refuzim i tenderit).*

Ky pretendim ankimorë nuk qëndron, pasi Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertës tonë ka vepruar në kundërshtim me gjendjen faktike.

Konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1& 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë ne kemi **angazhuar -Elida Harrila Liko (Bita), si eksperte të liçensuar në fushën konstruksione Urave dhe mureve.**

Arsyea e elemenimit nga AK që gjoja nuk i përmbush CV kriteret dhe konoform nenit 39.8(RROUP) është skandaloz dhe me tendeca favorizimi të kompanisë e cila është rekomanduar për kontratë, edhe sot nuk e kuptoj për cilat arsye CV nuk përmbush kërkesat e AK.

Pasi në CV znj Elida Liko si eksperte e liçensuar për konstruksione infrastukturore të nënshkruar nga vetë ajo ka paraqitur një numër të konsideruar gjithësejtë 500 kontrata e angazhuar si eksperte e strukturave.

Bazuar në provat (Materiale 1 dhe 2) e argumentuar poshtë konsiderojmë CV është përmbushur sipas kërkesave të AK, gjatë vlerësimit të Ofertës ka vepruar në kundërshtim te NENI 39.8 (RRUOP) dhe në pajtim me NENI 69 (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale) paragrafi 1,6 dhe 6.1të LPP-së nuk është dashur refuzohet oferta pa kërkuar informata plotësuese pasi koniderojmë që refrenca dhe CV lidhur me punën profesional të Znj:Elida Liko I përmbushë kërkesa mbi mundësit teknike dhe profesionale NENI 9.1&9.2 I FDT-së dhe Njoftimit për kontratë :

Neni 69
Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.

6. Në procedurat që shpjinë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve ose realizimi i aktiviteteve ndërtimore, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre teknike dhe profesionale për kryerjen e projekteve të tilla ose realizimin e aktiviteteve të tilla; në veçanti, autoriteti kontraktues mund të kërkojë të dhëna përkitazi me:

6.1 kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore;

Provë Materiale:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
Komisioni i Pranës i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudimit të Punëve të Ndërtimit

LICENCË
K.0628/5

MBIEMRI	LIKO (BITA)
EMRI	ELIDA
ATËSIA	HARILLA
DATËLINDJA	16.11.1957, Tiranë
VENDBANIMI	TIRANË
DIPLOMUAR, ME	1981
TITULLI	Ing. Ndërtimi Civile Industriale Ura
Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data :	24.07.2017

NË PROJEKTIM

Kat.	3	a	Projektim objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
		b	Projektim: 1. Objekte civile – industriale – turistike mbi 5 kata – 2. objekte me skelet metalik.
		c	Projektim: 1. Objekte me shtylla të lara vashtirasie Beton-arme – metalike – 2. Ingja dhe shpatë me deformueshmëri të ulët.
		d	Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.
		e	Projektim objekte civile e turistike prej druri.
Kat.	4	a	Projektim të installimeve hidro-termosanitare.
		f	Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
Kat.	6	a	Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
		b	Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.
Kat.	7	a	Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri 10 m.
		b	Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.
		c	Projektim urë-viadukte me hapësira të mëdha drite, ura të varura, ura me sisteme të paralduar stabilizimi dhe sisteme të tjera speciale.
		d	Projektim ura metalike.
		e	Projektim tunele rrugore - hekurudhore.

KRYETARI I KOMISIONIT
GËZTA LUBONJA

Në liçensen e lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Urban-Republikës së Shqipërisë është liçensuar për projektimin e urave dhe aftësisë mbajtëse të strukturave.

Referoju Dokumentit NR ..... të ngarkuar në Listën e Stafit ..... në e-prokurim te dokumentet e ngarkuar

Prova Nr 2:

Studio Hapësira-SH.P.K

Rr. MAT 1- Prishtinë
Nr. tel: 044/604-711; 044/536-914;045/560-280
edmond.halimi@hotmail.com ; besarthalimi@live.com
shevkethalimi@hotmail.com

Data

9.12.2019

REFERENCË

"Studio Hapsira Sh.P.K" me seli në Prishtinë , Rr MATI 1 , me numër Biznesit **71017222 , lëshon këtë letër reference për punëtorin ELIDA LIKO** , I punësuar Inxhinier i diplomuar i Ndërtimit-Civile, Industriale, Ura.

I njëjti ka treguar performance në marveshje bashpunimi me kompaninë Studio Hapsira Shpk duke filluar nga data 10.01.2017 dhe ka marrë pjesë në realizimin Projektim dhe mbikqyrje të projekteve në vijim :

1. **Hartimi i projekteve për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike – K.K Prizren (Hartimi i projekteve të infrastrukturës, rrugë, ujësjellës, kanalizime, shtretër të lumenjëve, mure mbrojtëse, Ura, hapësira publike, ndriçim publik etj.)- Kontratë Kornizë**
2. **Hartimin e Projektit Zbatues për kolektorin e Ujërave të zeza Nga lagja Sahiti Në Dumnicë**
3. **Përpilimin e projektit për dislokimin e infrastrukturës nëntokësore në QKUK për ndërtimin e klinikës së pediatrisë**
4. **Hartimin e projektit për asfaltimin e rrugës Selim Obranqa në Podujevë**
5. **Hartimi i Projekteve kryesore të objekteve, rethojave , shesheve, paraqeve , rrugeve ne Mamushe – K.K Mamushë**
6. **Hartimi i projektit të Çerdhes së fëmijeve ne hapsirat e shkollës "Lekë Dukagjini" në Prizren**
7. **Hartimi i projektit të banesës sociale në Kaçanik**
8. **Hartimi i aneksit të shkollës Mithat Frashëri në Krajk**
9. **Shërbimet e Projektimit të Objekteve në K.K Graçanicë**
10. **Hartimi i projekteve zbatues për nevojat e Komunës së Drenasit – K.K Drenas (Hartimi i projekteve të infrastrukturës, rrugë, ujësjellës, kanalizime, shtretër të**

lumenjëve, mure mbrojtëse, Ura, hapësira publike, ndriçim publik, objekte etj.) - Kontratë Kornizë

11. Hartimi i projekteve zbatues për nevojat e Komunës së Dragashit – K.K Dragash (Hartimi i projekteve të infrastrukturës, rrugë, ujësjellës, kanalizime, shtretër të lumenjëve, mure mbrojtëse, Ura, hapësira publike, ndriçim publik, objekte etj.) - Kontratë Kornizë
12. Hartimi i projektit për Ndërtimin e Urës mbi lumin Lepenc në fshatin Dallosh dhe Rrethrrotullimit në Hyrje të Kaçanikut – KK Kaçanik

Me respekt :
Studio Hapsira Shpk

Në Referencën e Lëshura me datë 09.12.2019 ***(Referoju listës së dokumenteve mbështetësetë ngarkuar në e-prokurim në Nr21 Dokumenti Referenca e stafit Studio Hapsira Shpk).*** **, Znj Elida Liko është angazhuar si bashkpuntore e jashtme për Kompaninë Studio Hapsira Shpk- Si Ekperte e Liçensuar për hartimin e projekteve dhe llogaritje të strukturave, urave dhe murëve mbrojtës, Referenca është e vulosur dhe nënshkruar nga Kompania " Studio Hapsira SHPK "**

Përmes Referencës Dëshmohet se znj Elida Liko si eksperte e liçensuar, është angazhuar dhe ka përfunduar me sukses disa projektet në ura, sipas listës së prezentuar në referencë .

1. **Elida Liko** ka projektuar projekte për nevojat e **Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prizren ,** ku si palë kontraktuese nga Kompania Studio Hapsira Shpk, në Kornizë të Kontratës e nënshkruar me datën **14.06.2018** me NR Prokurimi.662-18-002-21, Kjo kontratë është mbyllë me sukse ku keni të Bashkangjitur edhe Referencën për mbylljen me sukses të kësaj kontrate me datën **10.01.2020** ***(Referoju listës së dokumenteve mbështetësetë ngarkuar në e-prokurim në Nr 15 -Dokumenti Referenca e stafit Studio Hapsira Shpk NR 3).***
2. **Elida Liko** ka projektuar projekte për nevojat e **Drejtorisë së Urbanizimit në Komunën e Dragashit**, ku si palë kontraktuese nga Kompania Studio Hapsira Shpk, në Kontratën e Kornizë të nënshkruar me datën 16.04.2019 me NRProkurimi.621-18-9388-2-2-1 , Kjo kontratë është mbyllë me sukses ku keni të Bashkangjitur edhe Raportin/çertifikatën e pranimit të shërbimeve projektimi me datë 23.12.2019. ***(Referoju listës së dokumenteve mbështetësetë ngarkuar në e-prokurim në Nr 16 -Dokumenti Referenca e stafit Studio Hapsira Shpk NR 4).***
3. **Elida Liko** ka projektuar projekte për nevojat e **Drejtorisë së Urbanizimit në Komunën e Drenasit** , ku si palë kontraktuese nga Kompania Studio Hapsira Shpk, në Kontratën e Kornizë të nënshkmar me datën 24.07.2018 me NR Prokurimi 611-18-004-221,Kjo kontratë është mbyllë me sukses ku keni të Bashkangjitur edhe Raportin/çertifikatën e pranimit të shërbimeve projektimi me datë 21.12.2018 ***(Referoju listës së dokumenteve mbështetësetë ngarkuar në e-prokurim në Nr 15 -Dokumenti Referenca e stafit Studio Hapsira Shpk NR 3).***

4. **Elida Liko** ka projektuar projekte për nevojat e **Drejtorisë së Urbanizimit në Komunën e Kaçanikut** , ku si palë kontraktuese nga Kompania Studio Hapsira Shpk, në Kontratën e Kornizë të nënshkruar me datën 24.03.2017 me NR Prokurimi.KA652/17/10/236,Kjo kontratë është mbyllë me sukses ku keni të Bashkangjitur edhe Raportin/çertifikatëne e pranimit të shërbimeve projektimi me datë 29.11.2017 ***(Referoju listës së dokumenteve mbështetësetë ngarkuar në e-prokurim në Nr 13 -Dokumenti Referenca e stafit Studio Hapsira Shpk NR 1).***

Kjo refrencë dëshmon që pretendimi AK me të cilin na ka refuzuar tenderin - **I PA BAZUAR**

Prova nr 2:
Në kuadër të CV- të nënshkruar nga vetë ajo po I precizojmë disa kontrata ku janë përfshirë projektim të urave dhe mureve ku po I nënvizojmë :

TALLANT shpk
Design & Supervision

Adresa Rr. "Ujësh.Kosovë"; P. 33/2; Sh.1; Ap.1 Kat 1; Tirana.
Tel/Fax +355 4 2456016;
E-mail shpk.tallant2@gmail.com; info@tallantshpk.com
Web www.tallantshpk.com

EKSPERIENCA NE PUNE

PROJEKTE TE NDRYSHME "TALLANT SH.P.K"	
Periudha kohore	2008 – ne vazhdim
Vendodhja	Tirane, Shqiperi.
Klienti	Kliente te ndryshem publik, privat dhe donatore te huaj
Pozicioni	Projektuese dhe mbikqyrese e punimve.
Aktivitetet e kryera	▶ Hartimi i projekt preventivave per Rikonstruksionin e Shkollave të Arsimit Profesional ▶ Mbikqyrja e punimeve per objektin: "Rikonstruksioni i shkollës së mesme të bashkuar "Ymer Lala", Surrel" ▶ Loti i V-të: Studim projektim; per objektin: "Ndertim i shkollës 9 – vjecare Arbanë ▶ "Hartimi i Projektit dhe preventivit të zbatimit të punimeve për Ndërtimin e Shkollës Profesionale të IT –së Tiranë ▶ Supervizim i Rikonstruksionit te Godines se Pediatrise ▶ "Mbikqyrja e punimeve për objektin:Rehabilitimi dhe Instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollës 9-vjeçare "Mihal Grameno" ▶ "Projekt zbatimi per rikualifikimin urban teTeatrit "SKAMPA" ▶ Mbikqyrje PUnimesh per objektin: ▶ Permiresimi LLumizimit me Uje ne rrugen "Thoma Kodhaj" ▶ Kontrate mbikqyrje punimesh per Rikonstruksionin e 67 Qendrave Shendetsore ne qarqet Berat, Korce, Elbasan. LOT III ▶ Mbikqyrje Punimesh: Mbikqyrje per Rikualifikimin e Iagjes Kuartalla 1.18. Bashkia Durres ▶ Kontrate sherbimi Projektimi per objektin: ▶ Stacioni I pompimit Gorican dhe I kanaleve Ujites si dhe te 4 Rezervuareve Ujites, Urë Vajgurore. ▶ Furnizimi me ujë Rural IV ▶ Studimi i fizibilitetit. Ujësjellësin e Himarës dhe depozitimin e ujërave të zeza, misionin e gjetjes së fakteve në Orikum ▶ Shërbimet e mbikëqyrjes për nënprojektin e shpejtë në përmirësimin urban dhe përmirësimin e infrastrukturës (Berat dhe Përmet) ▶ Mbikqyrje punimesh per objektin : Furnizimi me uje I qytetit Puke, rrjeti I jashtem dhe I brendshem. ▶ Projekti per instalimin e angiografit dhe krijimin e repartit te hemodinamikes ▶ Studim Projektim i objekteve te Programit ARGJINATURA E LUMIT MAT, KRAHU I DJATHTE (ZONA TALE, LEZHE)

- **Sqarim**: Shifet qartë si provë materiale në kuadër të projekteve (Hartimin e projektevepër ndërtimin dhe rikonstruktimin e shkollave - Janë projektuar muret mbrojtëse rrethuese.
- Në kuadër të projektit Rikualifikim Urban të teatrit Skampa - Janë përfshirë në projekte dhe muret mbrojtëse rrethuese
- Në kuadër të projketit "Studimi Projektimi I Objekteve të Programit Arxhinaturat e Lumit" Mat, Krahu I Djathtë)- Janë përfshirë edhe muret stabilizuese mbrojtëse për mbrojtje të brixheve të Lumit Mat.

TALLANT shpk
Projekt & Supervizion

Adresa Rr. "Gjik Kuqali", P. 23/2, Sh.1, Ap.1 Kati 1, Tirane.
Tel/Fax +355 4 2456016;
E-mail shpk.tallant2@gmail.com; info@tallantshpk.com
Web www.tallantshpk.com

Agjensia Mirdite, Njesia Kurbin dhe LTM + Kabine shtyllore + LTU Kabina Lleshi N/st. Laç 1, Rajoni Burrel
- Supervizion punimesh Sistemim asfaltim e masa inxhinierike ne km 21+950 ne rrugen Qafe Thane – Lin – Pogradec
- Studim-Projektim per objekte te arsimit te mesem profesional LOT-VIII : Ndertimi i ri i nderteses se shkolles Agrobizines Charles Telford Ericson.
- Studim projektim për mbylljen e venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta Durrës; Librazhd; Sarande; Belsh; Cerrik; Prrenjas; (Lot1; Lot2; Lot3; Lot4; Lot5; Lot6)
- Mbikqyrje punimesh per "Rehabilitimi I rruges Transballkanike Fazat 1 dhe 2"
- Ndertimi I rruges Dhimiter Konomi Vlore
- Mbikqyrje punimesh per ndertimin e shetitores se Himares
- Supervizion punimesh per Permiresimi I furnizimit me uje I zones se plazhit, Lagjia 13, Durres
- Mbikqyrje punimesh per sistemimin dhe asfaltimin e rruges Sanxhak-Superstrade
- Mbikqyrje e punimeve per objektet "Rikonstruksioni I rruges Ade (karburanti) - Frakull e vogel , komuna Frakull" "Rikonstruksion I rruges Levan-Shtyllas, komuna Levan dhe "Sistemim asfaltim I rruges Toshkez-Zhelizhan-Mazhaj, komuna Allkaj."
- Mbikqyrje punimesh per rikonstruksionin e rruges Gryke Manati - Kolsh dhe ndertim I rruges se varrezave
- Mbikqyrje punimesh per sistemimin anesor te Perroit te Madh, Qender Voskop
- Mbikqyrje punimesh per punime rrugore, lot 2 me objekt:" Mbikqyrje punimesh per rikonstruksionin e rruges Kthesa e Bishanit-Bocove-Varezat e fshatit Bashkim"
- Hartimi I projektit per rikonstruksionin e godines ekzistuese te Kryesise se Kuvendit
- Hartim I Projekt Preventivit te zbatimit per Rikonstruksionin e fasadave te godinave ekzistuese te QSUT-se
- Projekt-preventiva zbatimi për rikonstruksionin e ambulancave dhe qendrave shëndetësore në Republikën e Shqipërisë - - Loti 6. "Projekt-preventiva zbatimi për rikonstruksionin e ambulancave dhe qendrave shëndetësore në Qarkun e Korçës
- Projekt-preventiva zbatimi për rikonstruksionin e ambulancave dhe qendrave shëndetësore në Republikën e Shqipërisë - - Loti

Sqarim:Në CV e Elida Liko janë përfshirë një lami projektesh. Në kuadër të rikonstruktimi të rrugëve rajonale, komunale dhe rajonale, në kuadër të rrugëve janë përfshirë edhe muret mbrojtëse dhe infrastuktura

përcjellëse.
Në këtë rast konform NENI 39.8 (RRUOP) dhe në pajtim me NENI 69 të LPP-së nuk është dashur te refuzohet oferta pa kërkuar informata plotësuese, pasi këto shumë lehtë mund të dështohen me kontrata dhe paramasë të inkuadruar në kontratë.

5. "Projekt-preventiva zbatimi për rikonstruksionin e ambulancave dhe qendrave shëndetësore në Qarkun e Kukësit
- Projekt-preventiva zbatimi për rikonstruksionin e ambulancave dhe qendrave shëndetësore në Republikën e Shqipërisë - Loti 4. "Projekt-preventiva zbatimi për rikonstruksionin e ambulancave dhe qendrave shëndetësore në Qarkun e Gjirokastrës
- Projektimi dhe mbikqyrja e punimeve per ProjektetShkolla koreografike (rehabilitim catis I sistemi ngrohes , sallat) Bashkia Tirane
- Projektimi dhe mbikqyrja e punimeve per Projektet Rikualifikimi I hapesirave publike dhe rruges hyrse prane memorialit te Rilindasve" Bashkia Gjirokaster.
- Projektimi dhe mbikqyrja e punimeve per Projektet . Rikualifikimi I fasadave dhe gjelberimi I ambienteve pereth pallatave pergjate bulevardit" Bashkia Selenice
- Projektimi dhe mbikqyrja e punimeve per Projektet Rikonstruksioni I godines se Kinoteatrit "Zihni Sako" Bashkia Gjirokaster
- Projektimi dhe mbikqyrja e punimeve per Projektet Rikonstruksioni I Pallatit te Kultures" Bashkia Gramsh.
- Projektimi dhe mbikqyrja e punimeve per Projektet II.
- Rehabilitimi I qendres (Rikonstruksion I fasadave, sheshit dhe ndricimit te bulevardit) Bashkia Gramsh
- Projektimi dhe mbikqyrja e punimeve per Projektet Fasadat e e qytetit dhe sistemimi I ndricimit dhe sheshit Bashkia Burrel
- Hartim I projekt preventivit te zbatimit per disa punime shtese ne ndertimin e bunkerit per Akseleratoret Lineare ne sp Onkologjik
- Supervizion I punimesh per objektin ndertimi I linjes se jashme te ujesjellesit Ballsh
- Mbikqyrje punimesh per sistemimin e skarpateve dhe perroit per paraburgimin e ri ne Berat
- Projektim: Ndertesa e re per dy akseleratore lineare te Spitalit Onkologjik në Spitalin Universitar të Tiranes "Nene Tereza". Pergatitja e vizatimeve paraprake, ekzekutive dhe preventive për ndërtimin e tyre
- Shërbime konsulence per projektimin dhe dokumentat e tenderit, asistence per PIU/PEA ne tenderim dhe kontrata dhe supervizim gjate ndertimit, Programi Bashkia Il Kamez

Sqarim : Në kuadër shërbimeve Konsulente në projektim dhe pregaditjen e tenderit për Bashkin e Kamës-Znj Elida Liko është angazhuar në kuadër të kompanisë Taulant Shpk si eksperte për rrugë, ura, mure mbrojtës-KONTRATË KORNIZË për sherbime inxhinierike për nevojat e Bashkisë së Kamëzës.

Në këtë rast konform NENI 39.8 (RRUOP) dhe në pajtim me NENI 69 të LPP-së nuk është dashur refuzohet oferta pa kërkuar informata plotësuese, pasi këto shumë letë mundë të dështohen me kontrata dhe paramasë të inkuadruar në kontratë.

- Kontrate sherbimi per kolaudim punimesh ndertimi per rikonstruksionin e rruges ne forme unaze qe fillon nga rruga nacionale "Tirane - Fushe Kruje", vazhdon nga ish fabrika e tullave, reparti ushtarak 3030 dhe del para shkolles 9 vjecare "Isa Boletini" (Unaza Koder-Kamez rreth 1300 ml objektet ne vazhdim
- Projektimi e preventivi i thellimit te kalates se re dhe te basenit te Portit Shengjin
- Kontrate sherbimi per kolaudim punimesh ndertimi gjate rikonstruksionit te rruges "Qemal Butka" (shtese kontrate)
- Kontrate sherbimi per kolaudim punimesh ndertimi gjate rikonstruksionit te Cerdhes Nr. 47
- Kontrate sherbimi per kolaudim punimesh ndertimi gjate instalimit te sistemit te ngrohjes ne Kopshtet Nr. 2/6/20/38X/29
- Shtese kontrate per mbikqyrjen e punimeve per objektin "Ndertim I Rruges Gramoz Pashko"
- Kontrate sherbimi per kolaudim punimesh ndertimi gjate rikonstruksionit te rruges "Qemal Butka"
- Shtese kontrate per mbikqyrjen e punimeve per objektin "Ndertim I Rruges Gramoz Pashko"
- Shtese kontrate per mbikqyrjen e punimeve per objektin "Rikonstruksion I Rruges se Dibres"
- Kontrate sherbimi per kolaudim punimesh ndertimi gjate rikonstruksionit te rruges "Preng Jakova"
- Kontrate Sherbimi - Projektimi : "Studim-Projektim i disa objekteve te Infrastruktures Rrugore ne qytetin e Tiranes per vitin 2013" Lot I : "Rikonstruksioni i rruges Imer Ndregjoni"
- Kontrate Sherbimi - Projektimi : "Studim-Projektim i disa objekteve te Infrastruktures Rrugore ne qytetin e Tiranes per vitin 2013" Lot III : "Rikonstruksioni i infrastruktures rrugore i bllokut kufizuar nga Fusha e Aviacionit - rruga Anesti Lubonja - Lumi Lana dhe rruga Artan Lenja"
- Kontrate Sherbimi - Projektimi : "Studim-Projektim i disa objekteve te Infrastruktures Rrugore ne qytetin e Tiranes per vitin 2013"
- Lot VII : "Rikonstruksioni i pjeses veriore te Unazes se Vogel"
- Kontrate Sherbimi - Projektimi : "Studim-Projektim i disa objekteve te Infrastruktures Rrugore ne qytetin e Tiranes per vitin 2013" Lot I : "Rehabilitimi i skarpatave te Lumit Lana (pjeset e demtuara).

6

SQARIM:Në CV e Elida Liko janë përfshirë në kuadër të Kontrata Komizë "Studim projektim të Objekteve Infrastukturore për nevoja e Qytetit Të Tiranës.

Në aspektin inxhinier, Objektet Infrastukturës rrugore quajmë të gjitha objeketet që ndërlidhen me infrastukturën rrugore, si mure mbrojtëse, ura, nënkalime, mbikalime, lëshesa pllakore si dhe kanale për trajtim ujërave atmosferik, gjithësej janë prezentuar dy kontrata konform kerkesave të AK-së.

PËRFUNDIM NË PRETENDIMIN 2 :

Znj Elida Liko -Në dokumente e prezentuar Studio Hapsira shpk , Në referencat Raporti/çertifikatën e pranimit të Lëshuara nga Autoritet Kontraktuese shifet qartë që ka përvojën duhur dhe dëshmon që ka projektuar me dhjetra projekte të Urave dhe Mureve mbrojtës.

Znj. Elida Liko e angazhuar në kuadër të Konipanisë Taulanti SHPK si punëtore e rregullte: si eksperte e liçensuar për ura dhe infrastukturës rrugore në CV e saj ka paraqitur një lami të gjerë të kontratash për rinkonstruksion të rrugëve, si dhe kontrata kornizë për shërbime komunale , ku I veqojmë dy kontrata"Studim Projektim të Objekteve infrastukturës rrugore përnevojat e Bashkisë Tiranë" ku në kuadër Objektet Infrastukturës rrugore quajmë të gjitha objeketet që ndërlidhen me infrastukturën rrugore, si mure mbrojtëse, ura, nënkalime,mbikalime, lëshesa pllakore si dhe kanale për trajtim ujërave atmosferik, gjithësej janëprezentuar dy kontrata konform kerkesave të AK-së.

Në kuadër të CV të prezentuar të Noterizuar me Noter "(r*eferoju dokumentit të ngarkuar në e-prokurim në Listën NR... Dokumenti NR*.....

Bazuar në Faktete e prezentuar kërkojmë që pretendimi i AK me të cilin na ka refuzuar tenderin të hudhet poshtë i pa lejuar dhe i pa bazuar në kundërshtim me NENI 39.8 (RRUOP), si dhe në kundërshtim me NENI 69 paragrafi 1,6 dhe 6.1 të LPP-së.

PRETENDIMI ANKIMORË 3:

- **Një (1) inixhinier i diplomuar i Mjedisit apo master me tre (3) vite përvoj pune pas diplomimit:**
  - *Ka ofruar të njejtin inxhinjer me O.E "3D Projekt" Znj. Eliona Çatipi, ku nenshkrimi i inxhinjeres ka dallim ne mes të kontrates të O.E " 3D Projekt" dhe O.E "Taulant" sh.p.k.; dhe*
  - *Nuk ka ofruar deshmi të mjaftushme për kontratat të ngjashme si lider me 60% referenca.*

Lidhur me pretendimin Ankimorë- Ju informojmë që Inxhinierja **znj Eliona Çatipi** e angazhuar si Inxhiniere e Mjedisi për kompaninë Taulant SHPK, është famijare e ngushte e Kompanisë. Taulant Shpk(Mbesë e pronarit), e njëjta në kompanin Taulant Shpk është e angazhuar me Kontratë të rregullt pune prej vitit 2017 deri me *(tanë si provë po e bashkangjisim deklarimin e pagave me listë të deklarimeve në ATK- ku verteton e znj Qatipi është punëtore e rregullte e Kompanisë Taulant SHPK shiqo Dokumentin në faqe 22/4 te ankeses)*, po ashtu si provë material mund të bashkangjesim deklarimet e rregullta mujore të pagës në Ministrin e Financave në Kuadër të Administratës Tatimore, po ashtu si provë mund ta percejllim edhe pagesa e rregullta në bankë.

Sa I përket nënshkrimit shifet Qartë që kompania 3D projekt e ka falcifikuar nënshkrimin dhe e njëjta e ka përdorur diplomë pa e aurorizim dhe dijeni të pronari , I njëjti ka bërë kontratë fiktive me nënshkrim të falcifikuar. Këtë mund ta vereni edhe CV që është punëtore e rregull e Kompanisë Taulant Shpk.

Lidhur me këtë çeshtje ne nuk marrim përgjegjësi kur dikush I përdorë dokumentet tona në mënyrë të pa autorizuar

Lidhur me këtë çeshtje ne jemi duke pregaditur dokumentacionet për me bo kallxim penal në polici për krime ekonomike, dhe të njëjtët do ti padisimi për keqpërdorim të dokumenteve zyrtare dhe nënshkrim të falcifikuar pa dijenin e pronarit

Provë; Kontrata e Noterizuar nga noteri:

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

e-mail : saimirsharka2615@gmail.com, Cel : 069 20 87 887
NOTER SAIMIR S. SHARKA

NR. 2128 REP
NR. 627 KOL

Tirane me, 23.06.2017

KONTRATE PUNE

Sot para meje, Noter Saimir S. Sharka, me zyre ne rrugen "Astrit Halluku", perball Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, u paraqiten :

PUNEDHENESI:

Person Juridik "TAULANT" shpk me perfaqesuese ligjore Znj.Ditika Hasan Qatipi, e dtl 11.3.1964, lindur e banuese ne Tirane, e paisur me ID G45311120M dhe nr dokumenti 025082918. NIPT K616170401., me seli ne Tirane.

I PUNESUARI:

Znj. Erjona Gezim Qatipi, e dtl. 22.04.1988, lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane, ID I85422065A. Inxhiniere Mmjedisi, Trajtim Uji.

Te dy madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ato kerkuan te redaktojne kete akt noterie :

Znj Ditika Qatipi perfaqesuese e shoqerise "Taulant" shpk, merr ne pune Znj. Erjona Qatipi , **per ushtrim profesioni si inxhiniere mjedisi.**

Merret ne pune per te gjitha objektet qe ka Firma TAULANT shpk, me profesionin drejtuese teknike.

Paga e saj mujore eshte 25.000 leke. (njezet e pese mije leke te reja).

Koha e punes **pese vjet duke filluar qe sot me nenshkrimin e kesaj kontrate.**

PUNEDHENESI eshte i detyruar te siguroje te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga Ligjet Shqipetare te punesimit si dhe Statusit te Firmes.

I punesuari duhet te permbushe detyrimet e firmes,te mbroje interesat e saj dhe te gjitha detyrimet qe i perkasin Firmes.

Punedhenesi per cdo parregullsi dhe te mete qe do te konstatoje tek i punesuari ka te drejten e zgjidhjes se kesaj kontrate.

Ne zbatim te kesaj kontrate palet jane marre vesh qe do ti referohen te gjitha dispozitave perkatese te Kodit te Punes.

Palet jane marre vesh se ne rast se ndonjeri prej tyre do ta prishe kete kontrate para afatit te percaktuar ketu, duhet te njoftoje palen tjeter nje muaj para. Sigurimet shoqerore do te likujdohen sipas Ligjeve ne fuqi.

Konform dispozitave ligjore te Kodit Civil dhe Kodit te Punes vertetohet edhe nga une noteri.

PUNEDHENESI
Shoq "TAULANT" shpk

NOTER PUBLIK
Saimir S. Sharka
NIPT: I61712001A

E PUNESUARA

Kemi dorëzu bashk me ofertën edhe kontraten në mes kompanisë Taulant Shpk dhe Znj Eliona Qatipi, ku shifet qartë që kontratë është nënëshkruar te Noteri mes dy palëve të cilët kanë qenë prezentë te noteri, nënshkrimet janë autentike dhe origjinale, permes kontratës së noterizuar te noteri, ku mund ta dëshmojmë kopjen origjinale.

Po ashtu edhe në CV e dorëzuar te ju gjatë fazës tenderuese, dëshmohet që është punëtore e rregullte e Kompanisë Taulant SHPK.

Bazuar në provat e argumentuar me lartë Konsiderojmë që AK, gjatë vlerësimit të Ofertës ka vepruar në kundërshtim te NENI 39.8 (RRUOP) dhe në pajtim me NENI 69 të LPP-së

nuk është dashur refuzohet oferta pa kërkuar informata plotësuese, pasi këto shumë lehtë mund të dëshmohen përmes kontratës së noterizuar dhe deklarimeve tatimore sipas listës së pagave.

Lidhur me pertendimin se gjoja lideri nuk I ka 60% të referencave, kjo është qesharake pasi Kompania TAULANT SHPK në periudhë 2017-2020 ka realizuar kontrat të ngjashme mbi 2 milion euro SHIQ SI PROVË: Listën e kontratave të ngarkuar në E-prokurim:

TAULANT shpk
Design & Supervision

Adresa Rr. "Gjik Kuqali"; P. 23/2; Sh.1; Ap.1 Kati 1; Tirane.
Tel/Fax +355 4 2456016;
E-mail shpk.taulant2@gmail.com; info@taulantshpk.com
Web www.taulantshpk.com

Titulli i Projektit	Data	Vlera e Kontrates	Klienti	Qyteti Shteti
Hartimi i Projekt Preventivave për Rikonstruksionin e Shkollave të Arsimit Profesional	7/02/2019	52,080,000 Lekë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Shqiperi

Vetëm kontrata: Hartimi I projekteve Preventivave për Rikonstruksionin e Shkollave të Arsmimit profesional ka vlerës 52,080.000 lekë, nëse konvertohet në euro: Kontrata ka vlerë 434,000 euro që tejkalon vlerën e parashikuar te këtij aktivitetit prokurimit të paraparë në kontratë-Konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1& 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

PRETENDIMI ANKIMOR NË KËTË PRETENDIM NUK QENDRON- Pasi në kuadër të paramases të Hartimit projekteve të Shpalluar nga Komuna e Vushtrisë, ka hartim dhe revidim Objekteve, andaj konsiderojmë që kjo referencë përmbushë kërkesat e AK për kontrata të natyrës së ngjashme.

Bazur në proven materiale në Pretendimin NR 3; Autoriteti Kontraktues Komuna Vushtrri ka vepruar në Kundërshtim NENI 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

PRETENDIMI ANKIMORË 4:

Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratës OE Arhiko Ing e cila është shpallur e pa përgjegjëshme-Konform mendimit të ekespertit, dhe vendimit OSHP-së NR 395-404/20 të dates 28.07.2020

Në listën e kontratave të prezentuar ka dorëzuar 339.499.16 euro prej njoftimit për kontratë e cila shifet qartë qe edhe në ekepertizen e ekepertit nuk e përmbush Kërkesen eAK- Konform

kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1&9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë me vlerë 400.000.00 euro në periudhën tri vjeqare prej momentit të njoftimit për kontratë.

Fakti 2: Lista e projekteve- ku me mbledhjen ne total te projekteve te realizuara brenda periudhës tri vjeçare janë nën vlerën 400.000,00€≥339.499,16€.

Lidhur me këtë pretendim edhe Komisioni I Vlersimit të Komunës së Vushtrisë në vendimin e shpallur në e-prokurim me datën 15.05.2020, ka rekomanduar për kontratë Kompaninë e cila nuk I plotëson-Kërkesa përshtatshmerisë mbi mundësin teknike /profesionale sipas FDT dhe Dosjes tenderit.

PËRFUNDIM :

Duke u bazuar në argumentet e specifikuara më lartë kërkojmë nga AK të bëjë anulimin e VENDIMIT PËR DHËNIE TË KONTRATËS, e njëjta ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe të marrë si të bazuar ankesën tonë, pasi konsiderojmë që AK gjatë këtij aktiviteti të prokurimit në masë substanciale nuk e ka rrespektuar LPP.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankuesit:

NENI 7 : Barazia në trajtim / jo-diskriminimi.
NENI 51 : Njoftimi i kritereve të dhënies kontratës.
NENI 56 : Dizpozita e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave .
NENI 59 : Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.
RRUOPP (Rregullat dhe Udhëzuesi Operativë i Prokurimit Publikë) , neni 39 dhe 39.8
Neni 69 : Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Gjerësa sa i përket OE ankuesit dytë "INFRATK"SHPK:

Të nderuar, AK me dt. 26.10.2020 na ka dërguar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim: "Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak se: Një inxhinier i gjeodezisë - me 2 (dy) vite përvojë pune pas diplomimit ose bachelor i diplomuar i gjeodezisë me 3 (tre) vite përvojë pune pas diplomimit-Mungon diploma e përkthyer në gjuhën zyrtare sipas LPP-së përdorimi i gjuhëve zyrtare në dokumentet e prokurimit publik; Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv)- minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit dhe te ketë te kryer se paku 2(dy) projekte në lëminë e projektimit të rrugëve te përfunduara te mureve ose urave BA; Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (drejtimi hidro)- minimum 3 vite përvojë pune pas

diplomimit dhe te ketë te kryer se paku 2(dy) projekte ne lëmin e projektimit te largimit te ujërave te zeza ose sipërfaqësore ose furnizimit me ujë (ujësjellësit); Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikes- minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit ne lëmin e projektimit te projekteve te ndriçimit publik ose kanaleve kabllovik elektrifikimit ose poste tele komunikacionit; Një (1) inxhinier i diplomuar i makinerisë - drejtimi i komunikacionit-minimum me tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit; Një (1) inxhinier i diplomuar i gjeodezisë - me 2 (dy) vite përvojë pune pas diplomimit ose bachelor i diplomuar i gjeodezisë me 3 (tre) vite përvojë pune pas diplomimit; Një (1) inxhinier i diplomuar Gjeolog apo master- minimum me tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit; Një (1) inxhinier i diplomuar i Mjedisit apo master- minimum me tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit. Nga dëshmia e Autorizimit më dt. 01.04.2020 për këtë dokumentacion tenderues VU644-20-713-2-1-1, ky del të ketë nënshkruar jashtë autorizimit të bërë.; Kontratat e stafit për periudhë të pacaktuar dhe kontratat dhe parakontrata për bashkëpunim nuk janë të hartuara sipas ligjit të punës. Kontratat e stafit nuk janë paraqitur sipas FDT-së, sikurse është kërkuar kontratat dhe para kontratat'', ndërsa e ka rekomanduar për kontratë **OE "Arhiko Ing O.P".**

Fillimisht ju sqarojmë se ne në njoftimin mbi vendimin e AK-së të **dt.01.06.2020,** jemi rekomanduar për kontratë nga ana e AK-së, ndërsa Arhiko Ing është shpallur si tenderues i eliminuar, i cili tani çuditërisht është rekomanduar për kontratë nga ana e AK-së.
Me 08.06.2020 AK e ka pezulluar këtë aktivitet të prokurimit sepse është dorëzuar Kërkesë për Rishqyrtim, dhe pas kërkesës është bërë ankesë në OSHP, ndërsa pas ankesës në OSHP paneli shqyrtues ka nxjerr vendimin me nr. 395-404-20, ku të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues që i kanë parashtruar kundër kompanisë tonë janë hedhur poshtë nga paneli shqyrtues si të pabazuara ndërsa lënda është kthyer ne rivlerësim.
Pas rivlerësimit AK-ja me dt.26.10.2020 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku e ka rekomanduar për kontratë OE Arhiko Ing O.P, veprim ky i AK-së shumë kundërthënës me vendimin paraprak pasi që njoftimin mbi vendimin e dt.01.06.2020 e kishte shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin se: Nuk i plotësojnë kërkesën për shërbime te kryera ne vlere prej 400,000.00 Euro, por kanë dorëzuar kontrata vetëm në vlerë prej 330,797.65 Euro, ku edhe pas sqarimeve të kërkuara nga AK rreth disa kontratave, nuk ka marr ndonjë përgjigje nga OE i rekomanduar për kontratë ndërsa edhe pse në njoftimin mbi vendimin e lartcekur e ka shpallur si tenderues të eliminuar, tani po e rekomandon për kontratë OE të cilin vet AK-ja ka konstatuar se është i papërgjegjshëm.
Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe duhet eliminuar si i tillë.
Sa i përket arsyeve të AK-së për eliminimin tonë, ju sqarojmë se këto arsye nuk qëndrojnë fare dhe janë të pa bazuara për arsyet si më poshtë:
Në lidhje me arsyen e parë të AK-së ku e ka cekur se mungon diploma e përkthyer në gjuhën zyrtare sipas LPP-së për inxhinierin e gjeodezisë z. Blerim Jashari, ju sqarojmë se ky pretendim i AK-së është plotësisht i pa bazuar pasi që në ofertën e prezantuar nga ne, diplomës se inxhinierit ne fjalë i kemi bashkangjitur edhe Nostrifikimin (të noterizuar), mirëpo me këtë arsyetim të saj AK-ja po e tregon jo seriozitetin e saj në lidhje me vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertës tonë, pasi që nëse do të analizohej në detaje oferta jonë do ta kishte parë nostrifikimin e noterizuar që i kemi bashkangjitur diplomës, andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura ky pretendim i AK-së është absurd dhe nuk qëndron.
Faktin se ky pretendim i AK-së nuk qëndron e ka vërtetuar edhe paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin nr. 395-404/20, ku OE i rekomanduar për kontratë tani (e atëherë ankues) kishe pretenduar

në ankesën e tij me të njëjtin pretendim sikurse pretendimin e AK-së tani, mirëpo në vendim është cekur qartë se pretendimi ankimor i Arhiko Ing është i pa bazuar pasi që në ofertë është bashkangjitur vendimi nga Këshilli Shtetëror për Njohje të Diplomës, ku ky dokument është edhe i noterizuar. Më këtë veprim AK-ja nuk e ka respektuar vendimin e lartcekur të OSHP-së pasi që edhe pse është vërtetuar se pretendimi kundër kompanisë tonë në lidhje me diplomën e gjeodetit Blerim Jashari, AK-ja përsëri e ka vendosur si arsye të eliminimit.

Pra të gjitha faktet e lartcekura e shpjegojnë shumë qartë se arsyetimi i AK-së në lidhje me diplomën e inxhinierit të lartcekur nuk qëndron dhe është plotësisht i pa bazuar.

Në lidhje me arsyen e dytë për eliminimin tonë ku AK-ja e ka cekur se sipas autorizimit të dt. 01.04.2020 për këtë dokumentacion, kontratat për inxhinierët e kërkuar janë nënshkruar nga një person i pa autorizuar, pra jashtë autorizimit të bërë, ju sqarojmë se as ky arsyetim i AK-së nuk qëndron për faktin se z.Veton Jahaj është drejtor ekzekutiv i kompanisë, ndërsa autorizimi i dt. 01.04.2020 ka qenë për nënshkrimin e dosjes, dokumentacionit tenderues, eventualisht edhe kontratës në rast se do të shpalleshim fitues.

Pra ky arsyetim i AK-së nuk qëndron sepse AK-jaju ka referuar vetëm autorizimit të dt.01.04.2020, mirëpo nëse do ta kishte analizuar në tërësi ofertën tonë do ta kishte shumë të qartë se Veton Jahaj është drejtor ekzekutiv i kompanisë tonë, andaj me këtë veprim të AK-së shihet qartë jo serioziteti i saj në lidhje me vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertës tonë, ashtu siç e cekëm edhe më lartë.

Ndërsa faktin se ky pretendim i AK-së është i pa bazuar dhe nuk qëndron e ka vërtetuar edhe paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin nr. 395-404/20, ku pas pretendimeve të OE ankues kundër kompanisë tonë, në vendimin e lartpërmendur është shpjeguar shumë qartë se ne në ofertën tonë e kemi bashkangjitur autorizimin në të cilin shkruan shumë qartë se Veton Jahaj është personi përgjegjës për çfarëdo nënshkrimi në këtë aktivitet të prokurimit. Mirëpo AK-ja edhe pse paneli shqyrtues e ka cekur shumë qartë se ne e kemi bashkangjitur autorizimin siç e cekëm më lartë nuk e ka marrë fare parasysh këtë fakt dhe na ka eliminuar në këtë aktivitet të prokurimit për një arsye krejtësisht absurde, ku me këtë veprim të saj AK-ja nuk e ka respektuar fare vendimin e lartpërmendur të OSHP-së.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekur shihet qartë se ky arsyetim i AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron dhe është krejtësisht i pa bazuar.

Gjithashtu edhe arsyeja tjetër e AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit ku e ka cekur se kontratat dhe para kontratat për bashkëpunim nuk janë te hartuara sipas Ligjit te punës dhe gjithashtu kontratat e stafit nuk janë paraqitur sipas FDT-së, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim është krejtësisht i pa bazuar pasi që ne i kemi prezantuar kontratat dhe parakontratat për bashkëpunim konfom kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, sepse në dosje të tenderit tek dëshmia e kërkuar dokumentare është e cekur shumë qartë se *"Lista e staflt profesional e nënshkruar dhe e vulosur, listës duhet të i bashkëngjiten këto dëshmi CV-a e nënshkruar kopje, Diploma kopje, Kontrata e punës apo para kontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi dhe Punëdhënësi si dhe e vulosur nga Punëdhënësi, të dorëzohet. në kopje "*, pra është shumë i qartë fakti se tek dëshmia dokumentare e kërkuar në lidhje me stafin askund nuk figuron se kontratat ose para kontratat duhen të jenë të hartuara sipas Ligjit te Punës, edhe pse ne i kemi ofruar konform ligjit të cilit AK-ja ju ka referuar gabimisht.

Këtë fakt e ka vërtetuar edhe vendimi i OSHP-së i lartpërmendur ku e ka cekur se në kontratat e stafit shkruan qartë se:

1. Vlefshmëria

Kjo kontratë ka vlefshmëri paraprake dhe me këtë status hynë në fuqi me datë 01.06.2009. kohëzgjatja është e pakufizuar dhe do të vazhdojë deri atëherë kur njëra nga palët kontraktuese

kërkon ndërprerjen e kësaj kontratë (shih pikën 4).
4.Kohëzgjatja e punësimit dhe ndërprerja e kontratës
4.1 Kohëzgjatja e punësimit është për periudhë të pacaktuar.
4.2 Ndërprerja e kontratës mund të bëhet nga të dy palët me një lajmërim me shkrim në kohë paralajmërimi prej katër javësh.

Ndërsa në Ligjin e Punës Neni 10, paragrafi 2 dhe 2.1-2.2 parashihet qartë se:

Ligji i Punës Neni 10, paragrafi 2 dhe 2.1-2.2

Neni 10
Kontrata e Punës

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.

2. Kontrata e Punës mund të lidhet për:

2.1. një periudhë të pacaktuar;

2.2. një periudhë të caktuar;dhe

2.3. për punë dhe detyra specifike.

Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se kontratat dhe parakontratat e bashkëpunimit të prezantuara nga ne janë konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe gjithashtu janë konform Ligjit të Punës, andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura dhe në vendimin e OSHP-së shihet qartë se arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë është i pa bazuar dhe nuk qëndron.
Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura shihet qartë se arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë është vetëm një pretekst për të na eliminuar neve si OE i përgjegjshëm, ndërsa faktin se ne jemi OE i përgjegjshëm e ka vërtetuar edhe vetë AK në njoftimin mbi vendimin e AK-së të dt.01.06.2020, ku na ka rekomanduar për kontratë. Pra këtu shihet jo-serioziteti i AK-së në lidhje me vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertës tonë ku një herë na rekomandon për kontratë, ndërsa tani na eliminon me arsye krejtësisht të pa bazuara, për të cilat arsye edhe paneli shqyrtues i OSHP-së i ka cilësuar si tëpa bazuaranë vendimin**Nr.395-404/20 të dt. 28.07.2020.**

Gjithashtu ne pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin e OE **"Studio Hapësira" sh.p.k & "Taulanti" sh.p.k.,** pasi që ky GOE është i papërgjegjshëm.
Ne me dt. 05.11.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.
Autoriteti kontraktues në arsyen e refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim vetëm se i ka vërtetuar edhe më shumë pretendimet tona ankimore, përderisa nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe nuk i ka ofruar dëshmi se pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara.
Është për tu habitur se si AK e ka cekur se në vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim i ka shqyrtuar pretendimet tona ankimore një nga një, mirëpo nuk ka ofruar asnjë dëshmi se pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara.
Gjithashtu në lidhje me pretendimin tonë ankimor se nuk është respektuar vendimi i OSHP-së nr.359-404/20, AK nuk e ka marrë parasysh fare këtë pretendim tonin duke e qartësuar dhe vërtetuar edhe më shumë se pretendimi ynë ankimor është tërësisht i bazuar. Pasi që nëse nuk do të ishte i

bazuar atëherë AK do të ofronte fakte ose dëshmi që tregojnë se është respektuar vendimi i OSHP-së dhe se pretendimet tonajanë të pa bazuara, mirëpo që një veprim i tillë nuk është bërë nga ana e AK-së, fakt ky që tregon qartë se ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit dhe një herit edhe më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë dhe se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.
Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i pa mbështetur në ndonjë dispozitë ligjore, pasi që e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim pa ofruar ndonjë dëshmi apo fakt ligjor.
Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i **pergjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet rne të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurohen që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe **më** të drejtë tëshfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **NTSH "INFRATEK"**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankuesi "INFRATEK"SHPK:

Neni1iLPP-së
Neni 6 i LPP-së
Ncni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Vendimi i OSHP-së Nr.395-404/20 të dt. 28.07.2020

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

B58 dt 26.10.2020- Vendimi i AK-së

REPUBLIK OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES
Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratë i dhënë nga autoriteti kontraktues : Hartimi i projekteve
Numri i aktivitetit të Prokurimit:

Nr. i prokurimit:	**VU644**	**2**	**0**	**7**	**1**	**3**	**2**	**1**	**1**
Nr. i brendshëm:	**VU644**	**2**	**0**	**0**	**0**	**8**	**2**	**1**	**1**

Nr	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	N.SH " 3D Project "	1.15 €
2.	" Eng Idea " shpk & " Sib-Beka" shpk	1.82 €
3.	" PROing & Partners " shpk & " Fidan Hasaj B.I "	3.71 €
4.	N.T.SH " Infratek "	0.97 €
5.	N.N.SH " Eni Desing " & " Rimi Eng " sh.p.k	13.59 €
6.	" GR Albania " Dega në Kosovë	2334.56 €
7.	" Arhiko Ing O.P "	1.16 €
8.	" Taulanti " sh.p.k " Studio Hapsira " sh.p.k	0.89 €

Rezultati i aktivitetit te prokurimit :

Komuna e Vushtrrisë **shpëblen** me kontrat O.E **Arhiko Ing O.P me seli në Prishtinë** , në vlerë respektivisht **çmini i peshuar me poentim : 1.16 €**

Data : 26.10.2020

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Ne baze te karakterisitikave dhe kritereve vleresues te tendereve te pergjiegjshem,

- Konfrom kriterit per dhenie te kontrates te specifikuar ne Njoftimin e Kontrates dhe ne Dosjen e Tenderit,
- Duke pasur parasysh dhe kriterin e vleresimit te permbushjes se kritereve per dhenie te kontrates te specifikuara ne Njoftimin per Kontrate dhe në Dosjen e Tenderit te secilit prej tenderuesve te pergjegjshem,

- Si dhe duke pasur parasysh treguesit e cmimeve te tenderuesve, si kriter per dhenie te kontrates "cmimi me i ulet me poentim ", rekomandojme qe me kontrate te shperblehet OE:" Arhiko Ing O.P." me seli në Prishtinë.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

/

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit "Taulant SHPK&Studio Hapsira SHPK":

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, fillimisht ky aktivitet i prokurimit është vlerësuar me datën 06.04.2020 dhe i përgjegjshëm është shpallur "Infratek"SHPK, dhe OE ankuesi Taulant Shpk&Studio Hapsira Shpk është eliminuar me arsyetimin se Deklarata nën betim nuk është plotësuar në rregull, i cili pretendim pas shqyrtimit të ankesës 395-404/20 me vendim të Panelit Shqyrtues është vlerësuar si devijim të vogël teknik, dhe se lënda është kthyer në rivlerësim. PSH 395-404/20 i dt 28.07.2020

Ekspertja Shqyrtuese gjatë shqyrtimit dhe analizimit të pretendimeve sqaron se, OE ankuesi gjatë procesit të rivlerësimit është eliminuar nga AK tani me arsyetimet si mëposhtë:

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak se :

- **Deklarata nën Betim jo e rregullët sepse:**
  Antari i Grupit të O.E "Taulant" sh.p.k deklaraten nën betim e ka plotësuar në menyrë jo të rregullut nga se në preambulën e deklaratës referenca është për O.E "Studio Hapsira" sh.p.k ndërsa të dhënat më tej O.E "Taulant" sh.p.k, rrjedhimisht kjo e bënë Deklaraten nën Betim jo të rregullt dhe jo valide.
  Për rrjedhoj parregullësi paaraqet devijim substancial nga kërkesat Administrative.

- **Një (1) inixhinier i diplomuar i ndërtimtaris (drejtimi konstruktiv) – minimum 3 vite përvoj pune pas diplomimit dhe të kete te kryer së paku dy (2) projekte të përfunduara të mureve ose urave BA;**
  - Nuk është paraqitur në CV pune të projekteve të mureve ose urave BA për Eldo Liko.
    Bazuar në nenin 39.8 të ROUP (citat) atëhere kur O.E ofron CV që nuk i përmbush kriteret atëhere dueht të refuzhet pa kerkim të infomacioneve shtese duke u mbestetur nënenin 69 të LPP-së (refuzim i tenderit).

- **Një (1) inixhinier i diplomuar i Mjedisit apo master me tre (3) vite përvoj pune pas diplomimit:**
  - *Ka ofruar të njejtin inxhinjer me O.E "3D Projekt" Znj. Eliona Çatipi, ku nenshkrimi i inxhinjeres ka dallim ne mes të kontrates të O.E " 3D Projekt" dhe O.E "Taulant" sh.p.k.; dhe*
  - *Nuk ka ofruar deshmi të mjaftushme për kontratat të ngjashme si lider me 60% referenca.*

Ekspertja tutje sqaron se, OE ankuesi në ankesë ka këto pretendime pra lidhur me arsyet e eliminimit të tyre si GOE, ku po ashtu ka edhe pretendimin e katërt lidhur me OE të rekomanduarin.

Sa i përket pretendimit të parë të OE ankuesit:

PRETENDIMI ANKIMORË 1:

Eleminimi jonë lidhur me pretendimin që njëri prej Grupit Operatorëve në këtë rast Taulant Shpk, ka dorëzuar Deklarate nen Betim jo valide, konsiderojmë pretendim ankimorë të gjykuar "Rest Juridicata", nuk është dashur ta përdorë AK pretendim për eleminimin tonë.

Gjatë plotësimit të deklaratës në Betim, ka ndodhur një devijim i vogël teknik për arsyes se kjo deklaratë në betim tek pjesa e identifikimit të OE është plotësuar qartë, këtu kemi parasysh faktin se emri i OE-së i mbetur si gabim teknik rezulton të jetë emri i antarit të OE-ve që janë antarë të grupit të OE-ve që janë në konzorcium njeri me tjetrin dhe kjo shihet qartë se është një gabim teknik që nuk ndryshon kushtin material të aktivitetit të prokurimit nga se gabimet të cilat mund të korigjohen pa ndryshuar kushtin material bazohen në NENI 59.4 të LPP-së.

Ky pretentim ankimorë e konsiderojmë të gjykuar " Rest Juridicata", Konform mendimit të ekspertit, dhe vendimit OSHP-së NR 395-404/20 të dates 28.07.2020.
PROVË MATERIALE :

O.E. " Studio Hapësira "Sh.p.k., ndërsa të dhënat më tej për O.E. " Taulant "Sh.p.k. Kjo e bënë Deklaratën nën Betim fictive, jo të rregullt dhe jo valide, për rrjedhojë dhe të papranueshme për A.K. Në fakt kjo parregullsi paraqet devijim substancial nga Kërkesat Administrative të saktësuara në Dosjen e Tenderit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se gabimin në deklaratën nën betim mund te konsiderohet një devijim i vogël teknik për arsye se kjo deklaratë tek pjesa Identifikimi i OE-së është e plotësuar qartë, këtu kemi parasysh faktin se emri i OE -së i mbetur si gabim teknik rezulton te jete emri i anëtarit te grupit te OE-ve qe janë në konzurcium njeri me tjetrin dhe kjo shihet se është veç një gabim teknik që nuk ndryshuar kushtin material te aktivitetit të prokurimit nga se gabimet të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material parashihen edhe në nenin 59.4 të LPP-së.

Bazur në proven materiale në **Pretendimin NR 1**; Autoriteti Kontraktues Komuna Vushtrri I ka ikur Vendimit të Oshp-së **OSHP-së NR 395-404/20 të dates 28.07.2020 dhe mendimi ekspertit, me këtë rast veprimi i Autoritetit Kontraktues është i palejuar dhe kundërshtim me NENI 59 paragrafi 4.**

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e parë të OE ankuesit sqaron se, ky pretendim është i gjykuar në lëndën 395-404/20 ashtu siq ka sqaruar OE ankuesi në pretendimin e mësipërm, andaj konsidroj se ky pretendim **gjendet i bazuar**, dhe AK nuk është dashur që të përdorë këtë arsyetim me rastin e eliminimit të OE ankuesit.

PRETENDIMI ANKIMORË 2:

- **Një (1) inixhinier i diplomuar i ndërtimtaris (drejtimi konstruktiv) – minimum 3 vite përvoj pune pas diplomimit dhe të kete te kryer së paku dy (2) projekte të përfunduara të mureve ose urave BA;**
  - Nuk është paraqitur në CV pune të projekteve të mureve ose urave BA për Eldo Liko. *Bazuar në nenin 39.8 të ROUP (citat) atëhere kur O.E ofron CV që nuk i përmbush kriteret atëhere dueht të refuzhet pa kerkim të infomacioneve shtese duke u mbestetur nënenin 69 të LPP-së (refuzim i tenderit).*

Ky pretendim ankimorë nuk qëndron, pasi Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertës tonë ka vepruar në kundërshtim me gjendjen faktike.

Konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1& 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë ne kemi **angazhuar -Elida Harrila Liko (Bita), si eksperte të liçensuar në fushën konstruksione Urave dhe mureve.**
Arsyea e eliminimit nga AK që gjoja nuk i përmbush CV kriteret dhe konform nenit 39.8 (RROUP) është skandaloz dhe me tendeca favorizimi të kompanisë e cila është rekomanduar për kontratë, edhe sot nuk e kuptoj për cilat arsye CV nuk përmbush kërkesat e AK.
Pasi në CV znj Elida Liko si eksperte e liçensuar për konstruksione infrastukturore të nënshkruar nga vetë ajo ka paraqitur një numër të konsideruar gjithësejtë 500 kontrata e angazhuar si eksperte e

strukturave.

Bazuar në provat (Materiale 1 dhe 2) e argumentuar poshtë konsiderojmë CV është përmbushur sipas kërkesave të AK, gjatë vlerësimit të Ofertës ka vepruar në kundërshtim te NENI 39.8 (RRUOP) dhe në pajtim me NENI 69 (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale) paragrafi 1,6 dhe 6.1 të LPP-së nuk është dashur refuzohet oferta pa kërkuar informata plotësuese pasi koniderojmë që refrenca dhe CV lidhur me punën profesional të Znj:Elida Liko I përmbushë kërkesa mbi mundësit teknike dhe profesionale NENI 9.1&9.2 I FDT-së dhe Njoftimit për kontratë :

Provë materiale:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

LICENCË
K.0628/5

MBIEMRI	LIKO (BITA)
EMRI	ELIDA
ATËSIA	HARILLA
DATËLINDJA	16.11.1957, Tiranë
VENDBANIMI	TIRANË
DIPLOMUAR, MË	1981
TITULLI	Ing. Ndërtimi Civile Industriale Ura
Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data :	24.07.2017

NË PROJEKTIM

Kat.	3	a	Projektim objekte civile – industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate
		b	Projektim: 1. Objekte civile – industriale – turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.
		c	Projektim: 1. Objekte me shkallë te larte vashtirësie Beton-arme – metalike – 2. krojo dhe shpate me deformueshmëri te ulët
		d	Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike
		e	Projektim objekte civile e industriale prej druri
Kat.	4	a	Projektim të installimeve hidro-termosanitare.
		f	Projektim të sistemeve kundra zjarrit
Kat.	6	a	Projektim rugë lokale, rugë urbane dyllëzore dhe rugë interurbane dyllëzore
		b	Projektim rugë urbane kryesore dhe rugë interurbane kryesore
Kat.	7	a	Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri 10 m.
		b	Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.
		c	Projektim urë/viadukte me hapësira te madhe drite, ura te varura, ura me sisteme te paralkuar statikisht dhe sisteme ti tjera speciale
		d	Projektim ura metalike.
		e	Projektim tunele rugore - hekurudhore.

KRYETARI I KOMISIONIT
GERTA LUBONJA

Në liçensen e lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Urban-Republikës së Shqipërisë është liçensuar për projektimin e urave dhe aftësisë mbajtëse të strukturave.
Referoju Dokumentit të ngarkuar në Listën e Stafitnë e-prokurim te dokumentet e ngarkuar:

Prova nr 2:

Studio Hapësira-SH.P.K

Data

9.12.2019

Rr. MAT 1- Prishtinë
Nr. tel: 044/604-711; 044/536-914;045/560-280
edmond.halimi@hotmail.com ; besarthalimi@live.com
shevdethalimi@hotmail.com

REFERENCË

"Studio Hapsira Sh.P.K" me seli në Prishtinë , Rr MATI 1 , me numër Biznesit **71017222 , lëshon këtë letër referënce për punëtorin ELIDA LIKO** , I punësuar Inxhinier i diplomuar i Ndërtimit-Civile, Industriale, Ura.

I njëjti ka treguar performance në marveshje bashpunimi me kompaninë Studio Hapsira Shpk duke filluar nga data 10.01.2017 dhe ka marrë pjesë në realizimin Projektim dhe mbikqyrje të projekteve në vijim :

1. **Hartimi i projekteve për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike – K.K Prizren (Hartimi i projekteve të infrastrukturës, rrugë, ujësjëllës, kanalizime, shtretër të lumenjëve, mure mbrojtëse, Ura, hapësira publike, ndriçim publik etj.)- Kontratë Kornizë**
2. **Hartimin e Projektit Zbatues për kolektorin e Ujërave të zeza Nga lagja Sahiti Në Dumnicë**
3. **Përpilimin e projektit për dislokimin e infrastrukturës nëntokësore në QKUK për ndërtimin e klinikës së pediatrisë**
4. **Hartimin e projektit për asfaltimin e rrugës Selim Obranqa në Podujevë**
5. **Hartimi i Projekteve kryesore të objekteve, rethojave , shesheve, paraqeve , rrugeve ne Mamushe – K.K Mamushë**
6. **Hartimi i projektit të Çerdhes së fëmijeve ne hapsirat e shkollës "Lekë Dukagjini" në Prizren**
7. **Hartimi i projektit të banesës sociale në Kaçanik**
8. **Hartimi i aneksit të shkollës Mithat Frashëri në Krajk**
9. **Shërbimet e Projektimit të Objekteve në K.K Graçanicë**
10. **Hartimi i projekteve zbatues për nevojat e Komunës së Drenasit – K.K Drenas (Hartimi i projekteve të infrastrukturës, rrugë, ujësjëllës, kanalizime, shtretër të**

lumenjëve, mure mbrojtëse, Ura, hapësira publike, ndriçim publik, objekte etj.) - Kontratë Kornizë

11. Hartimi i projekteve zbatues për nevojat e Komunës së Dragashit – K.K Dragash (Hartimi i projekteve të infrastrukturës, rrugë, ujësjellës, kanalizime, shtretër të lumenjëve, mure mbrojtëse, Ura, hapësira publike, ndriçim publik, objekte etj.) - Kontratë Kornizë
12. Hartimi i projektit për Ndërtimin e Urës mbi lumin Lepenc në fshatin Dallosh dhe Rrethrrotullimit në Hyrje të Kaçanikut – KK Kaçanik

Me respekt :
Studio Hapsira Shpk

Studio Hapsira

Përfundim i pretendimit dytë nga OE ankuesi:

Znj Elida Liko -Në dokumente e prezentuar Studio Hapsira shpk , Në referencat Raporti/çertifikatën e pranimit të Lëshuara nga Autoritet Kontraktuese shifet qartë që ka përvojën duhur dhe dëshmon që ka projektuar me dhjetra projekte të Urave dhe Mureve mbrojtës.

Znj. Elida Liko e angazhuar në kuadër të Konipanisë Taulanti SHPK si punëtore e rregullte: si eksperte e liçensuar për ura dhe infrastukturës rrugore në CV e saj ka paraqitur një lami të gjerë të kontratash për rinkonstruksion të rrugëve, si dhe kontrata kornizë për shërbimekomunale , ku I veqojmë dy kontrata"Studim Projektim të Objekteve infrastukturës rrugore përnevojat e Bashkisë Tiranë" ku në kuadër Objektet Infrastukturës rrugore quajmë të gjitha objeketet që ndërlidhen me infrastukturën rrugore, si mure mbrojtëse, ura, nënkalime,mbikalime, lëshesa pllakore si dhe kanale për trajtim ujërave atmosferik, gjithësej janëprezentuar dy kontrata konform kerkesave të AK-së.

Në kuadër të CV të prezentuar të Noterizuar me Noter "(r*eferoju dokumentit të ngarkuar në e-prokurim në Listën NR... Dokumenti NR* .....

Bazuar në Faktete e prezentuar kërkojmë që pretendimi i AK me të cilin na ka refuzuar tenderin tëhudhet poshtë i pa lejuar dhe i pa bazuar në kundërshtim me NENI 39.8 (RRUOP), si dhe nëkundërshtim me NENI 69 paragrafi 1,6 dhe 6.1 të LPP-së.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se në E-prokurim në ofertën e OE ankuesit me qëllim të analizimit të pretendimit, ka analizuar CV-në dhe dokumentet lidhur me pretendimin, dhe se konsideron se ky pretendim gjendet i **bazuar** me faktin se në Njoftimin për kontratë të AK-së kërkohet:

Kërkesa 2 - 2. Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme si vijon – Menaxheri i projektit - inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv)- minimum tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit dhe te këtë te kryer se paku 1 (një) projekt ne pozitën e menaxherit për hartimin e projekteve (Hartim te projekteve te ndërtimit te lart dhe te ulet ose hartim te projekteve te infrastrukturës rrugore.) Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë(drejtimi arkitekturës)- minimum 3 vite përvoje pune pas diplomimit dhe te ketë te kryer se paku 2(dy) projekte ne lëmin e projektimit te rrugëve – Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë(drejtimi konstruktiv)- minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit dhe te ketë te kryer se paku 2(dy) projekte te përfunduara te mureve ose urave BA; - Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (drejtimi hidro)- minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit dhe te ketë te kryer se paku 2(dy) projekte ne lëmin e projektimit te largimit te ujërave te zeza ose sipërfaqësore ose furnizimit me ujë (ujësjellësit); - Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikes- minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit ne lëmin e	**Dëshmia 2 - Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe e vulosur, listes duhet të i bashkangjiten këto dëshmi CV-a e nënshkruar kopje, Diploma kopje, Kontrata e punës apo para kontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi dhe Punëdhënësi si dhe e vulosut nga Punëdhensi, të dorëzohet në kopje.**

Ekspertja tutje sqaron, pra AK ka kërkuar dëshmi të stafit për përfundimin e minimum dy projekte të mureve ose urave BA, gjerësa znj Elida Liko ka qenë bashkpunëtore për disa projekte hartuese të cilat janë të ngarkuara në ofertën e ankuesit, por që e njejta nuk i ka të përditësuara në CV projektet të cilat i ka cekur si sqarim në ankesë OE ankuesi, pra të përshkruara tek aktivitetet e kryera/ eksperienca në punë, dhe meqë OE ankuesi ka të bashkangjitura edhe referenca për projekte të ngjajshme, e cila vlenë të theksohet se znj Elida Liko ka edhe licencën e cila përkon me aktivitetin e prokurimit. Andaj bazuar në nenin 39.8 Rruopp citat:

CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund te vendos	Mund te kërkohen informata sqaruese	69

PRETENDIMI ANKIMORË NR 3 I OE ANKUESIT:

- **Një (1) inixhinier i diplomuar i Mjedisit apo master me tre (3) vite përvoj pune pas diplomimit:**
  - *Ka ofruar të njejtin inxhinjer me O.E "3D Projekt" Znj. Eliona Çatipi, ku nenshkrimi i inxhinjeres ka dallim ne mes të kontrates të O.E " 3D Projekt" dhe O.E "Taulant" sh.p.k.; dhe*
  - *Nuk ka ofruar deshmi të mjaftushme për kontratat të ngjashme si lider me 60% referenca.*

Lidhur me pretendimin Ankimorë- Ju informojmë që Inxhinierja **znj Erijona Çatipi** e angazhuar si Inxhiniere e Mjedisi për kompaninë Taulant SHPK, është famijare e ngushte e Kompanisë Taulant Shpk(Mbesë e pronarit), e njëjta në kompanin Taulant Shpk është e angazhuar me Kontratë të rregullt pune prej vitit 2017 deri me *(tanë si provë po e bashkangjisim deklarimin e pagave me listë të deklarimeve në ATK- ku verteton e znj Qatipi është punëtore e rregullte e Kompanisë Taulant SHPK shiqo Dokumentin në faqe 22/4 te ankeses)*, po ashtu si provë material mund të bashkangjesim deklarimet e rregullta mujore të pagës në Ministrin e Financave në Kuadër të Administratës Tatimore, po ashtu si provë mund ta percejllim edhe pagesa e rregullta në bankë.

Sa I përket nënshkrimit shifet Qartë që kompania 3D projekt e ka falcifikuar nënshkrimin dhe e njëjta e ka përdorur diplomë pa e aurorizim dhe dijeni të pronari , I njëjti ka bërë kontratë fiktive me nënshkrim të falcifikuar. Këtë mund ta vereni edhe CV që është punëtore e rregull e Kompanisë Taulant Shpk.

Lidhur me këtë çeshtje ne nuk marrim përgjegjësi kur dikush I përdorë dokumentet tona në mënyrë të pa autorizuar

Lidhur me këtë çeshtje ne jemi duke pregaditur dokumentacionet për me bo kallxim penal në polici për krime ekonomike, dhe të njëjtët do ti padisimi për keqpërdorim të dokumenteve zyrtare dhe nënshkrim të falcifikuar pa dijenin e pronarit.

Provë; Kontrata e Noterizuar nga noteri:

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

e-mail : saimirsharka2615@gmail.com, Cel : 069 20 87 887
NOTER SAIMIR S. SHARKA

NR.2128 REP
NR.627 KOL

Tirane me, 23.06.2017

KONTRATE PUNE

Sot para meje, Noter Saimir S. Sharka, me zyre ne rrugen "Astrit Balluku", perball Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, u paraqiten :

PUNEDHENESI:

Person Juridik "TAULANT" shpk me perfaqesuese ligjore Znj.Ditika Hasan Qatipi, e dtl 11.3.1964, lindur e banuese ne Tirane, e paisur me ID G45311120M dhe nr dokumenti 025082918. NIPT K616170401., me seli ne Tirane.

I PUNESUARI:

Znj. Erjona Gezim Qatipi, e dtl. 22.04.1988, lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane, ID I85422065A. Inxhiniere Mmjedisi, Trajtim Uji.

Te dy madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.
Ato kerkuan te redaktojne kete akt noterie :
Znj Ditika Qatipi perfaqesuese e shoqerise "Taulant" shpk, merr ne pune Znj. Erjona Qatipi , **per ushtrim profesioni si inxhiniere mjedisi.**
Merret ne pune per te gjitha objektet qe ka Firma TAULANT shpk, me profesionin drejtuese teknike.
Paga e saj mujore eshte 25.000 leke. (njezet e pese mije leke te reja).
Koha e punes **pese vjet duke filluar qe sot me nenshkrimin e kesaj kontrate.**.
PUNEDHENESI eshte i detyruar te siguroje te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga Ligjet Shqipetare te punesimit si dhe Statusit te Firmes.
I punesuari duhet te permbushe detyrimet e firmes,te mbroje interesat e saj dhe te gjitha detyrimet qe i perkasin Firmes.
Punedhenesi per cdo parregullsi dhe te mete qe do te konstatoje tek i punesuari ka te drejten e zgjidhjes se kesaj kontrate.
Ne zbatim te kesaj kontrate palet jane marre vesh qe do ti referohen te gjitha dispozitave perkatese te Kodit te Punes.
Palet jane marre vesh se ne rast se ndonjeri prej tyre do ta prishe kete kontrate para afatit te percaktuar ketu, duhet te njoftoje palen tjeter nje muaj para. Sigurimet shoqerore do te likujdohen sipas Ligjeve ne fuqi.

Konform dispozitave ligjore te Kodit Civil dhe Kodit te Punes vertetohet edhe nga une noteri.

PUNEDHENESI
Shoq "TAULANT" shpk

NOTER PUBLIK
Saimir S. Sharka
NUIS: I61713004A

E PUNESUARA

Kemi dorëzu bashk me ofertën edhe kontraten në mes kompanisë Taulant Shpk dhe Znj Erijona Qatipi, ku shifet qartë që kontratë është nënëshkruar te Noteri mes dy palëve të cilët kanë qenë prezentë te noteri, nënshkrimet janë autentike dhe origjinale, permes kontratës së noterizuar te noteri, ku mund ta dëshmojmë kopjen origjinale.

Po ashtu edhe në CV e dorëzuar te ju gjatë fazës tenderuese, dëshmohet që është punëtore e rregullte e Kompanisë Taulant SHPK.

Bazuar në provat e argumentuar me lartë Konsiderojmë që AK, gjatë vlerësimit të Ofertës

ka vepruar në kundërshtim te NENI 39.8 (RRUOP) dhe në pajtim me NENI 69 të LPP-së nuk është dashur refuzohet oferta pa kërkuar informata plotësuese, pasi këto shumë lehtë mund të dëshmohen përmes kontratës së noterizuar dhe deklarimeve tatimore sipas listës së pagave.

Ekspertja Shqyrtuese gjatë shqyrtimit të pretendimit, konsideron se pretendimi i OE ankuesit **gjendet i bazuar**, për faktin që kompania Taulant SHPK shihet qartë se të gjitha kontratat e stafit profesional i ka të noterizuara dhe se noteri ka qenë prezentë i cili e vërteton se nënshkrimet janë vendosur nga përsonat kompetent në fjalë.

Pretendimi tjetër i OE ankuesit:

Lidhur me pertendimin se gjoja lideri nuk I ka 60% të referencave, kjo është qesharake pasi Kompania TAULANT SHPK në periudhë 2017-2020 ka realizuar kontrat të ngjashme mbi 2 milion euro SHIQ SI PROVË: Listën e kontratave të ngarkuar në E-prokurim:

TAULANT shpk
Design & Supervision

Adresa Rr. "Gjik Kuqali"; P. 23/2; Sh.1; Ap.1 Kati 1; Tirane.
Tel/Fax +355 4 2456016;
E-mail shpk.taulant2@gmail.com; info@taulantshpk.com
Web www.taulantshpk.com

Titulli i Projektit	Data	Vlera e Kontrates	Klienti	Qyteti Shteti
Hartimi i Projekt Preventivave për Rikonstruksionin e Shkollave të Arsimit Profesional	7/02/2019	52,080,000 Lekë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Shqiperi

Vetëm kontrata: Hartimi I projekteve Preventivave për Rikonstruksionin e Shkollave të Arsmimit profesional ka vlerës 52,080,000 lekë, nëse konvertohet në euro: Kontrata ka vlerë 434,000 euro që tejkalon vlerën e parashikuar te këtij aktivitetit prokurimit të paraparë në kontratë-Konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1& 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

PRETENDIMI ANKIMOR NË KËTË PRETENDIM NUK QENDRON- Pasi në kuadër të paramases të Hartimit projekteve të Shpalluar nga Komuna e Vushtrisë, ka hartim dhe revidim Objekteve, andaj konsiderojmë që kjo referencë përmbushë kërkesat e AK për kontrata të natyrës së ngjashme.

Bazur në proven materiale në Pretendimin NR 3; Autoriteti Kontraktues Komuna Vushtrri ka vepruar në Kundërshtim NENI 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i

tenderëve.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, AK në njoftimin për kontratë ka kërkuar:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për shërbime të ngjashme me natyrën e aktivitetit, në vlerë minimale prej 400,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Nëse OE tenderojnë si grup i operatoreve ekonomik apo konsorcium, atëherë lideri i grupit duhet t'i ketë 60% të vlerës së kërkuar.	**Dëshmia 1- Një listë të kontratave të realizuara, nënshkruar dhe e vullosur ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve. (i) kur shërbimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) ose referencë të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur shërbimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;**

Ekspertja shqyrtuese sqaron tutje, se OE ankuesi gjegjësishtë lideri i konzorciumit në ofertën e tij ka të bashkangjtur listën e kontratave të realizuara të nënshkruar dhe të vulosur, dhe mendoj se si lider ka të paraqitur më tepër se 60% të kontratave të realizuara, andaj pretendimi i OE ankuesit **gjendet i bazuar.**
Pra nëse marrim kontratat nga data e publikimit për kontratë, po i vendosim disa nga projektet e ngjajshme:

"Hartim I projekt preventive zbatimi per Rikonstruksionin e	28/04/2017	72,000 Leke	Gjykata Apelit	Tirane, Shqiperi

Hartimi I projektit për "Rikonstruksionin e sallës së Komandës dhe ambjenteve të jashtme të shtesës së ndërtesës së centralit në HEC Vau I Dejës"	31/03/2017	576,000 Leke	KESH sh.a (Korporata Elektronenergjitike Shqiptare)	Shkoder, Shqiperi

Titulli i Projektit	Data	Vlera e Kontrates	Klienti	Qyteti Shteti
Hartimi i Projekt Preventivave për Rikonstruksionin e Shkollave të Arsimit Profesional	7/02/2019	52,080,000 Lekë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Shqiperi
Hartimi i Projekt Preventivave për Rikonstruksionin e Shkollave të Arsimit Profesional	11/10/2019	34,800,000 Lekë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Shqiperi

PRETENDIMI ANKIMORË 4:

Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratës OE Arhiko Ing e cila është shpallur e pa përgjegjëshme-Konform mendimit të ekespertit, dhe vendimit OSHP-së NR 395-404/20 të dates 28.07.2020

Në listën e kontratave të prezentuar ka dorëzuar 339.499.16 euro prej njoftimit për kontratë e cila shifet qartë qe edhe në ekepertizen e ekepertit nuk e përmbush Kërkesen e AK-Konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI9.1&9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë me vlerë 400.000.00 euro në periudhën tri vjeqare prej momentit të njoftimit për kontratë.

Fakti 2: Lista e projekteve- ku me mbledhjen ne total te projekteve te realizuara brenda periudhës tri vjeçare janë nën vlerën 400.000,00€≥339.499,16€.

Lidhur me këtë pretendim edhe Komisioni I Vlersimit të Komunës së Vushtrisë në vendimin e shpallur në e-prokurim me datën 15.05.2020, ka rekomanduar për kontratë Kompaninë e cila nuk I plotëson-Kërkesa përshtatshmerisë mbi mundësin teknike /profesionale sipas FDT dhe Dosjes tenderit.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, AK gjatë procesit të vlerësimit ka kërkuar sqarim nga OE Arhiko Ing, por kjo e fundit nuk ju ka përgjigjur, andaj edhe AK e ka shpallur të eliminuar në herën e parë, mëposhtë bashkangjitur gjeni kërkesën e AK-së për sqarim dt.30.04.2020 si dhe përgjigja e AK-së në kërkesën për rishqyrtim më dt.05.06.2020 kuka dhënë këtë arsye për refuzim--citat:'

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Rr. "Isa Boletini" nr.44, tel. 038-200-42-403

E-mail: prokurimi.vushtrri@rks-gov.net

Letër Standarde e kërkesës për sqarim dhe informacion shtesë të tenderit

14 Nr. 128/20

Dt. 30.04.2020 - Vushtrri

Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria për Prokurim Publik - Vushtrri

" Arhiko Ing O.P. " – K. Prishtinë

Z. Shefshet Morina

Nr1 i prokurimit	**VU644-20-713-2-1-1**

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Nr i brendshëm	644 - 20 - 008 - 211

Titulli: Hartimi i projekteve

I/e nderuar(a) z. Morina,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim " LPP ".

Gjatë procesit të ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderit të juaj, me theks të veçantë gjatë procesit të vlerësimit përmbushjes së kërkesave lidhur me mundësitë teknike dhe / ose profesionale tuaja, ne kemi vërejtur se nuk janë dorëzuar në plotni dhe, për rjedhojë ne si A.K., nuk e kemi të qartë vlerën e shërbimeve të përfunduara në periudhën tre vjeçare, ashtu sikurse është saktësuar në Dosjen e Tenderit. Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD) neni 9.1 lidhur me & 9.2 , pika 1, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale.

Andaj, për të vlerësuar dhe qartësuar deri në maksimum dhe në mënyrë të duhur tenderin e Juaj, ne, në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-së lidhur me nenin 39 të Rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurimin Publik, për të plotësuar dëshmitë e Juaja, kërkojmë nga Ju të na dorëzoni, me sa vijon :

1. **Na sqaroni dhe ofroni dëshmi të pranueshme ashtu sikurse është saktësuar në pikën 1 të Kërkesave mbi mundësitë teknike, mbi vlerën finansiare të shërbimeve të përfunduara dhe të pranuara që mbulon periudhën e pranueshme tre vjeçare, sipas Kontratës së dorëzuar të dt. 22.02.2016, e lidhur me Komunën e Lipjanit;**

2. **Na sqaroni dhe ofroni dëshmi të pranueshme ashtu sikurse është saktësuar në pikën 1 të Kërkesave mbi mundësitë teknike, mbi vlerën finansiare të shërbimeve të përfunduara dhe të pranuara që mbulon periudhën e pranueshme tre vjeçare, sipas Kontratës së dorëzuar të dt. 19.02.2020, e lidhur me Komunën e Lipjanit;**

Përgjigjen e Juaj sqaruese duhet të dorëzohen **me shkrim,** në adresën e lartë shënuar të Autoritetit Kontraktues, apo në e-mailin : (**prokurimi.vushtrri@rks-gov.net**) brenda **3 (tri) ditëve, pas dates së dërgimit të kësaj kërkese, respektivisht jo më largë se data 04.05.2020 , n'ora 14.00.**

Asnjë ndryshim në asnjë term të materialit ose në aspekt të tenderit të juaj nuk guxon të ofrohet përmes sqarimit të juaj.

Pa përgjigjën nga ana e juaj, në kërkesën e Autoritetit Kontraktues brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të **refuzohet.**

Me respekt,

Drejtoria për Prokurim Publik

_____

Hyda Dallku, ZPP

Mëposhtë gjeni përgjigjen e AK-së në kërkesë për shqyrtim dt. 05.06.2020:

3. Më tej, A.K., bazuar në procesin e vlerësimit dhe ekzaminimit të Listës së shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë si dhe referencave të dorëzuara për të dëshmuar vlerën e shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit, ka konstatuar se vlera e shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit e dëshmuar përmes referencave nuk përmbushë vlerën e kërkuar prej 400.000,00€ ashtu sikurse është saktësuar në Fleta e të Dhënave të Tenderit, Kërkesat mbi mundësitë Teknike dhe / ose profesionale, neni 9.1 lidhur 9.2 pika 1. Duke qenë se A.K. ka vlerësuar se dokumentacioni i dorëzuar në dukje është jo i plotë, në pajtim me dispozitat e nenit 72 pika 1 të LLP-së lidhur me nenin 41.7 të RRUOPP, më dt. datë 30.04.2020 përmes Kërkesës – Dokumentit standard për sqarim tenderi dërguar përmes Platformës elektronike – e-prokurim dhe e-mail ka kërkuar informatë plotësuese lidhur me disa dëshmi shtesë për të qartësuar plotësimin ose jo të kërkesave lidhur me aftësitë teknike dhe / ose profesionale të tenderuesit, në këtë rast Ankuesit. Ankuesi, brenda afatit të saktësuar në kërkesë, nuk i ka dorëzuar, as në e-mail dhe as , në pajtim me nenin 39.8 të RRUOPP, citat:" A.K. duhet ti dërgojë Kërkesë për sqarim tenderi O.E. përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe O.E. duhet ta dorëzojë përgjigjen e tyre tek A.K. në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik" mbarim citati, nuk i ka ngritur në platformën e e-prokurimit, dëshmitë e kërkuara që tregojnë apo pohojnë se ai i përmbushë Kërkesat mbi aftësitë teknike dhe / ose profesionale, sikurse parashihet në nenin 69 të LPP-së, lidhur me nenin 9.1 & 9.2 pika 1 të Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD) të Dosjes së Tenderit dhe nenin 39 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik. Si Autoritet Kontraktues, nuk kemi marrë asnjë përgjigje dhe / ose shpjegim nga Ankuesi lidhur me kërkesën e parashtruar brenda afatit kohorë të dhënë dhe po ashtu nuk kemi marrë asnjë informatë mbi ndonjë arsye të mosdorëzimit me shkrim të dëshmive të kërkuara. Rrjedhimisht, për shkak se vlera e shërbimeve të përfunduara suksesshëm në tre vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, të dëshmuara përmes referencave kapë shumën prej 330.797,65€ që donë të thotë se nuk përmbushë vlerën prej 400.000,00€ ashtu sikurse është kërkuar në pikën 1 të nenit 9.1 lidhur me 9.2 të FTD-së si dhe për shkak të mos përgjigjes së Ankuesit në kërkesën e A.K. për dëshmi shtesë, A.K. , në pajtim me nenin 39 pika 39.7 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik. citat : " dështimi i O.E. për ti paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit të saktësuar në kërkesë, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet dhe Autoriteti Kontraktues do të vazhdoi me procedurën, në pajtim me dispozitat e LPP-së që rregullojnë këtë situatë " mbarim i citatit, ka vendosur që tenderi i Ankuesit të refuzohet për arsyet sikurse u theksua më lartë në këtë njoftim.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron tutje, se në përgjigjen e pranuar më pastaj nga OE Arhiko Ing, se gjaja ju kanë dhënë sqarimet e kërkuara AK-së, kjo e fundit kërkon pastaj nga ASHI që të vërtetohet komunikimi përmes e-mailit citat:'

4. Mbi këto konstatime të A.K., dhe mbi bazën e pretendimit të Ankuesit se Ankuesi i ka dërguar A.K. dëshmitë e kërkuara në e-maiin zyrtar : prokurimi.vushtrri@rks-gov.net , A.K. në rrugë zyrtare , me Kërkesë, i është drejtuar Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit më tej (ASHI) në mënyrë që ky i fundit të vërtetoi pretendimet e Ankuesit se, më dt. 04.05.2020, a ka pasur komunikim zyrtar mes e-mailit të Ankuesit dhe e-mailit të A.K. Në përgjigjen e tij me shkrim ASHI informon zyrtarisht A.K. se citat: " bazuar në kriteret e përcaktuara për kërkim elektronik, nga zyra e prokurimit në KK-Vushtrri, për datën 04.05.2020 mes adresës elektronike : arhiko.ing@gmail.com dhe llogarisë elektronike zyrtare: prokurimi.vushtrri@rks-gov.net, në skanerin e domenit: @rks-gov.net nuk është gjetur ky komunikim" mbarim citati. Bazuar në konstatimin e ASHI-së, A.K. vërteton padiskutueshëm se Vendimi i A.K. për eliminim të Ankuesit nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit është marrë në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 39 pika 30.7 të RROUPP.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron, se në vendimin e panelit shqyrtues 395-404/20, ka konstatuar se AK konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së AK mund të kërkoj sqarime nga OE ankuesi, por rastin konkret siq e cekëm më lartë, AK ka kërkuar sqarime më 04.05.2020 mirpo nuk ka marrë përgjigje, andaj edhe e ka eliminuar, mirpo gjatë procesit të rivlerësimit AK nuk kërkon prap sqarim konform vendimit të PSH 395-404/20, por ia merr si të mirqenë sqarimet e dërguara, disa fatura për të cilat ka nënshkuar kërkesën mbi sekretet afariste për arsye se përmbajnë transaksione bankare, citat vendimi i PSH 395-404/20:'

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Arhiko.ing" O.P, se AK e ka eliminuar pa të drejtë me arsyetimin se nuk i përmbushë Kërkesat sikurse janë kërkuar tek FDT, Kërkesat mbi mundësitë Teknike dhe / ose profesionale, neni 9.1 lidhur 9.2 pika 1. Ku ky i fundit nuk ka dorëzuar Listën e shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë si dhe referencave të dorëzuara për të dëshmuar vlerën e shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se OE ankues ka ofruar Listën e Projekteve dhe disa dëshmi përkatës konstatojmë se me rastin e Rivlerësimit AK në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së mund të kërkoj sqarime nga OE ankues në mënyrë që të vërtetoj se OE në fjalë a përmbush kërkesën e AK-së, të cekur si më lart.

Citat E-maili i OE Arhiko Ing, i ngarkuar në E-prokurim më 21.05.2020"

5/21/2020 Gmail - Sqarim tenderi

Gmail

Arhiko ING <arhiko.ing@gmail.com>

Sqarim tenderi

1 message

Arhiko ING <arhiko.ing@gmail.com> Mon, May 4, 2020 at 1:02 PM
To: Prokurimi Vushtrri <prokurimi.vushtrri@rks-gov.net>

Titulli: Hartimi i projekteve
Nr. i prokurimit VU644-20-713-2-1-1

Pershendetje,

Referuar kerkeses per informata shtese te bashkangjitu gjeni deshmite per kontraten 22.02.2016 mbi vlerat financiare te perfunduara dhe te pranuara ne periudhen 3vjeqare.
Ndersa saj perket kontates se dates 19.02.2020 ne kemi kryer nje mori projektesh por ende nuk jane te mbuluara me vleren monetare.
Gjithashtu gjeni te bashkangjitur kerkesen per sekret afarist pasi qe ne keto shenime paraqiten transaksionet e kompanise.

Me Respekt,
Staff Arhiko.ing
–

arhiko.ing

ARHIKO.ING O.P.

One generation plants trees, the next generation enjoys the shade.

2 attachments

Kerkese per konfidencialitet.pdf
265K

Faturat dhe transferi bankar.pdf
22952K

Ekspertja Shqyrtuese sqaron tutje, se në fatura janë të dëshmuara transaksionet bankare si dhe faturat nga OE Arhiko Ing, ku dhe AK ka shpallur të njejtin si të përgjegjshëm për dhënie të kontratës. Pretendimi i OE ankuesit gjendet **pjesërishtë i bazuar.**

Si konkludim, pretendimet e OE ankuesit "Taulanti SHPK &Studio Hapsira SHPK" gjenden të bazuara dhe meqenëse OE ankuesi është me cmimin më të lirë sesa i rekomanduari atëhere AK rekomandohet që Aktivitetin e Prokurimit ta kthej në rivlerësim dhe procesin e rivlerësimit ta bëjë konform LPP_së dhe Rruopp-së, gjithashtu rekomandohet që ofertat e ofertuesve ti vlerësoj dhe ekzaminoj konform LPP-së dhe Rruopp-së duke dhënë sqrimet më të detjuara në rastin e eliminimit të tyre.

Gjerësa sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit "INFRATEK"SHPK:

Ekspertja Shqyrtuese fillimisht sqaron se i njejti me datën 01.06.2020 është shpallur i rekomanduar nga AK, mirpo pas ankesës të OE ankuesve "Taulant Shpk&Studio Hapsira Shpk" dhe "Arhiko Ing OP" me vendim të PSH 395-404/20 dt.28.07.2020 ky aktivitet i prokurimit është kthyer në rivlerësim, dhe tani pas rivlerësimi AK e ka shpallur të eliminuar me arsyetimet:

- **Një (1) inixhinier i gjedoezisë – me dy (2) vite përvoj pune pas diplomimit ose bachelor i diplomuar i gjeodezis me tre (3) vite pervoj pune pas diplomimit;**
  - Mungon diploma e përkthyer në gjuhen zyrtare sipas LPP –së Përdorimi i gjuhve zyrtare në dokumentet e prokurimit publik.
- **Një (1) inixhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv) minimum tre (3) vite përvoj pune pas diplomimit dhe te kete të kryer së paku dy (2) projekte në lemin e projektimit të rrugëve.**
- **Një (1) inixhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv) minimum tre (3) vite përvoj pune pas diplomimit dhe te kete të kryer së paku dy (2) projekte të përfunduara të mureve ose urave BA;**
- **Një (1) inixhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (drejtimi hidro) minimum tre (3) vite përvoj pune pas diplomimit dhe te kete të kryer së paku dy (2) projekte në lëmin e**

projektimit të largimit të ujrave të zeza ose siperfaqësore ose furnizim me ujë (ujësjellës);

- **Një (1) inixhinier i diplomuar i elektroteknikës - minimum tre (3) vite përvoj pune pas diplomimit në lëmin e projektimit të ndriqimit publik ose kanleve kabllovike , elektrifikimit ose posttelekuminikacionit;**

- **Një (1) inixhinier i diplomuar i makinerisë (drejtimi i komunikacionit) - minimum tre (3) vite përvoj pune pas diplomimit;**

- **Një (1) inixhinier i diplomuar i gjeodezisë – me dy (2) vite përvoj pune pas diplomimit ose bachelor i diplomuar i gjeodezisë me tre (3) vite përvoj pune pas diplomimit;**

- **Një (1) inixhinier i diplomuar Gjeolog apo master - minimum tre (3) vite përvoj pune pas diplomimit;**

- **Një (1) inixhinier i diplomuar i Mjedisit apo master - minimum tre (3) vite përvoj pune pas diplomimit.**

- Nga dëshmia e Autorizimit më datë 01.04.2020 për këtë dokumentacion tenderues VU644-20-713-2-1-1, ky del të ketë nënshkruar jashtë autorizimit të bërë.
  z. Fatmir Krasniqi 01.06.2009 - kontraten e nenshkruar nga Veton Jaha;
  z. Albert Elshani 10.09.2012 - kontraten e nenshkruar nga Veton Jaha;
  z. Idriz Shala 01.03.2005 - kontraten e nenshkruar nga Veton Jaha; dhe
  z. Bekim Ahmeti 03.06.2013 - kontraten e nenshkruar nga Veton Jaha.

Kontratat e stafit për periudhë të pacaktuar edhe kontratat dhe para kontrata për bashkpunim nuk janë të hartuara sipas Ligjit të Punës me Nr. 03/L-212, perkatesisht nenit 10 pargrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2 dhe nenint 11 të ketij ligji dhe si rrjedhoj keto kontrata janë të jashtligjehme dhe ne mos perputhje me ligjin e lartëcekur.

Kontratat e stafit s'janë paraqitur sipas FTD-së, sikurse është kërkuar kontratat dhe parakontratat.

Ekspertja tutje sqaron se, OE ankuesi "Infratek"SHPK si pretendime i ka këto arsye të eliminimit të tij.

Po i citojmë arsyetimet e OE ankuesit sa i përket pretendimeve:

Pas rivlerësimit AK-ja me dt.26.10.2020 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku e ka rekomanduar për kontratë OE Arhiko Ing O.P, veprim ky i AK-së shumë kundërthënës me vendimin paraprak pasi që njoftimin mbi vendimin e dt.01.06.2020 e kishte shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin se: Nuk i plotësojnë kërkesën për shërbime te kryera ne vlere prej 400,000.00 Euro, por kanë dorëzuar kontrata vetëm në vlerë prej 330,797.65 Euro, ku edhe pas sqarimeve të kërkuara nga AK rreth disa kontratave, nuk ka marr ndonjë përgjigje nga OE i rekomanduar për kontratë ndërsa edhe pse në njoftimin mbi vendimin e lartcekur e ka shpallur si tenderues të eliminuar, tani po e rekomandon për kontratë OE të cilin vet AK-ja ka konstatuar se është i papërgjegjshëm.
Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe duhet eliminuar si i tillë.

Ekspertja Shqyrtuese pretendimin e OE ankuesit lidhur me OE të rekomanduarin e gjenë **pjesërishtë të bazuar**, me faktin se në vendimin e panelit shqyrtues 395-404/20, PSH ka konstatuar se AK konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së mund të kërkoj sqarime nga OE ankuesi, por rastin konkret siq e cekëm më lartë (Tek pretendimi i katërt te OE ankuesi i parë), AK ka kërkuar sqarime më 04.05.2020 mirpo nuk ka marrë përgjigje, andaj edhe e ka eliminuar, mirpo gjatë procesit të rivlerësimit AK nuk kërkon prap sqarim konform vendimit të PSH 395-404/20, por ia merr si të mirqenë sqarimet e dërguara, faturat/transaksionet për të cilat ka nënshkuar kërkesën mbi sekretet afariste për arsye se përmbajnë transaksione bankare.

Pretenedimi i OE ankuesit - Sa i përket arsyeve të AK-së për eliminimin tonë, ju sqarojmë se këto arsye nuk qëndrojnë fare dhe janë të pa bazuara për arsyet si më poshtë:

Në lidhje me arsyen e parë të AK-së: ku e ka cekur se mungon diploma e përkthyer në gjuhën zyrtare sipas LPP-së për inxhinierin e gjeodezisë z. Blerim Jashari, ju sqarojmë se ky pretendim i AK-së është plotësisht i pa bazuar pasi që në ofertën e prezantuar nga ne, diplomës se inxhinierit ne fjalë i kemi bashkangjitur edhe Nostrifikimin (të noterizuar), mirëpo me këtë arsyetim të saj AK-ja po e tregon jo seriozitetin e saj në lidhje me vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertës tonë, pasi që nëse do të analizohej në detaje ofertën tonë do ta kishte parë nostrifikimin e noterizuar që i kemi bashkangjitur diplomës, andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura ky pretendim i AK-së është absurd dhe nuk qëndron.
Faktin se ky pretendim i AK-së nuk qëndron e ka vërtetuar edhe paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin nr. 395-404/20, ku OE i rekomanduar për kontratë tani (e atëherë ankues) kishe pretenduar në ankesën e tij me të njëjtin pretendim sikurse pretendimin e AK-së tani, mirëpo në vendim është cekur qartë se pretendimi ankimor i Arhiko Ing është i pa bazuar pasi që në ofertë është bashkangjitur vendimi nga Këshilli Shtetëror për Njohje të Diplomës, ku ky dokument është edhe i noterizuar. Më këtë veprim AK-ja nuk e ka respektuar vendimin e lartcekur të OSHP-së pasi që edhe pse është vërtetuar se pretendimi kundër kompanisë tonë në lidhje me diplomën e gjeodetit Blerim Jashari, AK-ja përsëri e ka vendosur si arsye të eliminimit.
Pra të gjitha faktet e lartcekura e shpjegojnë shumë qartë se arsyetimi i AK-së në lidhje me diplomën e inxhinierit të lartcekur nuk qëndron dhe është plotësisht i pa bazuar.

Ekspertja Shqyrtuese pretendimin e OE ankuesit e gjenë **të bazuar**, duke u bazuar në faktin se i njejti pretendim ka qenë në lëndën 395-404/20, dhe se e kemi konfirmuar se në ofertën e OE ankuesit është bashkangjitur vendimi nga Këshilli Shtetëror për Njohje të Diplomës, ku ky dokument është edhe i noterizuar.

PSH. 395-404/20 dt.28.07.2020.

Ndërsa lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka ofruar Inxhinierin e Gjeodzisë me diplomë në gjuhën Kroate gjë që ka ber shkelje të LPP-së neni 13-Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e Prokurimit publik.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankuesit nuk qëndron i bazuar, për arsye se në Ofertë te i rekomanduari shihet qe Gjeodeti Blerim Jashari ka bashkangjitur edhe Vendimin nga Këshilli Shtetëror për Njohje të Diplomës ku ky dokument është edhe i noterizuar.

Në lidhje me arsyen e dytë për eliminimin tonë ku AK-ja e ka cekur se sipas autorizimit të dt. 01.04.2020 për këtë dokumentacion, kontratat për inxhinierët e kërkuar janë nënshkruar nga një person i pa autorizuar, pra jashtë autorizimit të bërë, ju sqarojmë se as ky arsyetim i AK-së nuk qëndron për faktin se z.Veton Jahaj është drejtor ekzekutiv i kompanisë, ndërsa autorizimi i dt. 01.04.2020 ka qenë për nënshkrimin e dosjes, dokumentacionit tenderues, eventualisht edhe kontratës në rast se do të shpalleshim fitues.
Pra ky arsyetim i AK-së nuk qëndron sepse AK-ja ju ka referuar vetëm autorizimit të dt.01.04.2020, mirëpo nëse do ta kishte analizuar në tërësi ofertën tonë do ta kishte shumë të qartë se Veton Jahaj është drejtor ekzekutiv i kompanisë tonë, andaj me këtë veprim të AK-së shihet qartë jo serioziteti i saj në lidhje me vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertës tonë, ashtu siç e cekëm edhe më lartë.
Ndërsa faktin se ky pretendim i AK-së është i pa bazuar dhe nuk qëndron e ka vërtetuar edhe paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin nr. 395-404/20, ku pas pretendimeve të OE ankues kundër kompanisë tonë, në vendimin e lartpërmendur është shpjeguar shumë qartë se ne në ofertën tonë e kemi bashkangjitur autorizimin në të cilin shkruan shumë qartë se Veton Jahaj është personi përgjegjës për çfarëdo nënshkrimi në këtë aktivitet të prokurimit. Mirëpo AK-ja edhe pse paneli shqyrtues e ka cekur shumë qartë se ne e kemi bashkangjitur autorizimin siç e cekëm më lartë nuk e ka marrë fare parasysh këtë fakt dhe na ka eliminuar në këtë aktivitet të prokurimit për një arsye krejtësisht absurde, ku me këtë veprim të saj AK-ja nuk e ka respektuar fare vendimin e lartpërmendur të OSHP-së.
Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekur shihet qartë se ky arsyetim i AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron dhe është krejtësisht i pa bazuar.

Ekspertja Shqyrtuese ketë pretendim e gjenë të bazuar, të cilën e kemi shqyrtuar në vendimin e dt. 28.07.2020 PSH.395-404/20. Ndërsa sa i përket nënshkimeve tek kontratat e të punësuarve nga personi z.Veton Jahaj i cili nga AK pretendohet se nuk ka qenë i autorizuar para datës 01.04.2020, për këtë rast AK konform nenit 72 të LPP-së mund të kërkoj informata sqaruese, në mënyrë që të vërtetoj pozitën e Drejtorit Ekzekutiv!

Identifikimi i Operatorit Ekonomik	
Emri i Kompanisë	N.T.SH INFRATEK
Adresa e plotë:	RR. BEDRI SHALA 38C, 10 000 PRISHTINË, KOSOVË
I përfaqësuar nga:	
Emri	VETON JAHAJ
Pozita	DREJTOR EKZEKUTIV
Nënshkrimi	
Data	06.04.2020
Vula	

Gjithashtu edhe arsyeja tjetër e AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit ku e ka cekur

se kontratat dhe para kontratat për bashkëpunim nuk janë te hartuara sipas Ligjit te punës dhe gjithashtu kontratat e stafit nuk janë paraqitur sipas FDT-së, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim është krejtësisht i pa bazuar pasi që ne i kemi prezantuar kontratat dhe parakontratat për bashkëpunim konfom kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, sepse në dosje të tenderit tek dëshmia e kërkuar dokumentare është e cekur shumë qartë se *"Lista e staflt profesional e nënshkruar dhe e vulosur, listës duhet të i bashkëngjiten këto dëshmi CV-a e nënshkruar kopje, Diploma kopje, Kontrata e punës apo para kontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi dhe Punëdhënësi si dhe e vulosur nga Punëdhënësi, të dorëzohet. në kopje "*, pra është shumë i qartë fakti se tek dëshmia dokumentare e kërkuar në lidhje me stafin askund nuk figuron se kontratat ose para kontratat duhen të jenë të hartuara sipas Ligjit te Punës, edhe pse ne i kemi ofruar konform ligjit të cilit AK-ja ju ka referuar gabimisht.

Këtë fakt e ka vërtetuar edhe vendimi i OSHP-së i lartpërmendur ku e ka cekur se në kontratat e stafit shkruan qartë se:

1. Vlefshmëria

Kjo kontratë ka vlefshmëri paraprake dhe me këtë status hynë në fuqi me datë 01.06.2009. kohëzgjatja është e pakufizuar dhe do të vazhdojë deri atëherë kur njëra nga palët kontraktuese kërkon ndërprerjen e kësaj kontratë (shih pikën 4).

4.Kohëzgjatja e punësimit dhe ndërprerja e kontratës

4.1 Kohëzgjatja e punësimit është për periudhë të pacaktuar.

Ndërprerja e kontratës mund të bëhet nga të dy palët me një lajmërim me shkrim në kohë paralajmërimi prej katër javësh.

Ndërsa në Ligjin e Punës Neni 10, paragrafi 2 dhe 2.1-2.2 parashihet qartë se:

Ligji i Punës Neni 10, paragrafi 2 dhe 2.1-2.2

Neni 10
Kontrata e Punës

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.

2. Kontrata e Punës mund të lidhet për:

2.1. një periudhë të pacaktuar;

2.2. një periudhë të caktuar;dhe

2.3. për punë dhe detyra specifike.

Ekspertja Shqyrtuese edhe këtë pretendim e gjenë të bazuar, e cila është e shqyrtuar me dt.28.07.2020 PSH.395-404/20.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se, sa i përket Ligjit të punës 03/212 neni 10 paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2 thuhet se citat: "2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike", andaj në kontratat e stafit është e cekura afati si me poshtë:

1. Vlefshmëria
Kjo kontratë ka vlefshmërinë paraprake dhe me këtë status hyn në fuqi me datë 01.06.2009. Konkurrenca është e pakufizuar ,dhe do të vazhdojë deri afëronë kur njëra nga palët kontraktuese kërkon ndërprerjen e kësaj Kontrate (shih Pikën 4).

OE ankuesi:

Ne me dt. 05.11.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.
Autoriteti kontraktues në arsyen e refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim vetëm se i ka vërtetuar edhe më shumë pretendimet tona ankimore, përderisa nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe nuk i ka ofruar dëshmi se pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se AK në kërkesën për rishqyrtim nuk i ka dhënë arsyet e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim.

SI konkludim, pretendimet e OE ankuesit"Infratek"SHPK gjenden të bazuara dhe AK rekomandohet që Aktivitetin e Prokurimit ta kthej në rivlerësim dhe procesin e rivlerësimit ta bëjë konform LPP_së dhe Rruopp-së, gjithashtu rekomandohet që ofertat e ofertuesve ti vlerësoj dhe ekzaminoj konform LPP-së dhe Rruopp-së duke dhënë sqrimet më të detjuara në rastin e eliminimit të tyre.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA E VUSHTRRISË.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues –"TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK"

OE"INFRATEK"SHPK